

ENGJELL ANGONI

PASTHIRRMAT NË GJUHËN E SOTME SHQIPE *

GRUPET E PASTHIRRMAVE SIPAS KUPTIMIT

Sipas kuptimit pasthirrmat do t'i ndajmë në dy grupe të mëdha: 1/ *pasthirrma emocionale*, që shprehin ndjenja, dhe 2/ *pasthirrma urdhërore*, që shprehin dëshirën a vullnetin e folësit. Secili nga këto grupe do të ndahet në nëngrupet përkatëse, ku pasthirrmat do të trajtohen më në hollësi nga pikëpamja e ndjenjave dhe e dëshirave që ato shprehin.

Nga numri i pasthirrmave emocionale disa shprehin ndjenja të pastra, që i jeton vetë folësi (gëzim, admirim, frikë, tmerr etj.), ndërsa disa të tjera shprehin vlerësimin emocional të realitetit që na rrethon (të veprimeve a të të folurit të personave të tjerë, të gjendjes së ambientit, të natyrës etj.), pra gjendje emocionale intelektuale (miratim, mospëlqim, dyshim, mosbesim, ironi etj.). Krahaso:

a) Olimbia — (e pataksur) *Uaaa!* Qënkam ata të pianos!? Nikollaqi — Kush janë, the?! (Spiro Çomora, Karnavalet e Korçës, 201).

b) Guri u shqetësua. I tha: — Ngreu të shkojmë te doktori. — *Aha*, s'ngrihem dot, — tha ai. — Tani është vonë. Më janë prerë këmbët. (A. Kristo, Shkëndijat, 488).

Por duhet vënë në dukje se është e vështirë, thuajse e pamundur, që të vendosësh një kufi të prerë ndërmjet pasthirrmave që shprehin përgjithësisht ndjenja pa nuancë vlerësimi dhe pasthirrmave që shprehin vlerësim emocional të realitetit që na rrethon.

Pasthirrmat urdhërore, me anën e të cilave u drejtohem i të tjerëve, shërbejnë për të shprehur dëshirën a vullnetin e folësit. Përdoren si mjete ndikimi e shtytjeje. Në këtë grup hyjnë pasthirrmat që shprehin lutje, dëshirë, urdhër, thirrje, nxitje, ndalim etj.

I. PASTHIRRMAT EMOCIONALE

Pasthirrmat e këtij grupi shërbejnë për të shprehur gëzim, kënaqësi, pakënaqësi, habi, frikë, tmerr, keqardhje, dhimbje, dëshpërim, hidhërim, mallëngjim, mosbesim, zemërim, kërcënim, mburrje, përbuzje, mospërfillje, ironi etj. Për të shprehur kaq ndjenja e nuanca të ndryshme përdoren pasthirrma të formuara nga tinguj të veçantë dhe pasthirrma të formuara nga material leksikor. Në këtë drejtim rëndësinë më të madhe e ka jo aq përbërja tingullore e pasthirrmave se sa intonacioni me të cilin ato shqiptohen dhe konteksti. Është pikërisht intonacioni dhe konteksti që tregojnë vlerën e vërtetë të një pasthirrme. Shpesh ndodh që sipas dëshirës a qëllimit të folësit e njëjta pasthirrmë shpreh

*) Pjesa e parë e këtij studimi është botuar në Nr. 4 të revistës sonë.

ndjenja krejt të ndryshme, gjë që realizohet në sajë të intonacionit, i cili ndryshon sipas ndjenjës që shpreh pasthirrma, ndërsa karakteri i ndjenjës kushtëzohet nga përmbajtja kuptimore e gjithë fjalisë ku ndodhet pasthirrma, ose nga rrethanat e vërteta të të folurit. Kështu, ndërmjet të tjerash, pasthirrma *ah* mund të përdoret për të shprehur admirim, gëzim, ironi, keqardhje, kënaqësi, tmerr, urrejtje. etj., ndërsa pasthirrma *oh* mund të përdoret për të shprehur dëshpërim, dhimbje, gëzim, habi, keqardhje, mosbesim, pikëllim etj. P.sh.

a) pasthirrma *ah*:

— *admirim*, Nëna, *ah* sa gjë e madhe është nëna për shtëpinë, (N. Jorgaqi, Dashuria, 99);

— *gëzim*, — Posi. Pa tjetër do të shihemi! Do t'ju shkruaj. Po, pa tjetër do t'ju shkruaj. Kurrë s'do t'ju harroj! — *Ah* sa mirë. (P. Marko, Hasta, 89);

— *keqardhje*, *ah!* tha Bejua, si s'kemi edhe ne një mortajë (Z. Sako, Nga jeta, 7);

— *kënaqësi*, — *Ah*, sa qejf! — tha prapë Exheri. (I. Kadare, Kështjella, 129);

— *tmerr*, *Ah* — ja bëri me tmerr i panjohuri! (I. Kadare, Kështjella, 178);

— *urrejtje*, *Ah*, qen, Musolini! *Ah*, katil o fashizëm që na shkatërrrove jetën! (P. Marko, Hasta, 126);

b) pasthirrma *oh*

— *dëshpërim*, «*Oh*, po sikur... të mos ndodhë gjë?» — mendoj i dëshpëruar dhe shikoi me kujdes orën. (S. Sulejmani, Gjëmimet, 40);

— *dhimbje*, Shpresa, që e kuptoi menjëherë ç'kërkonte, i foli: — Na e vranë, Ylli, na e vranë! — *Oh!*... (J. Xoxa, Juga, I, 28);

— *gëzim*, — *Oh*, sa mirë! Mua më pëlqen byreku me djathë, — tha ai me gëzim, duke u hedhur në tokë. (N. Prifti, Pika, 35);

— *Habi*, — *Oh!* — shpërtheu një britmë habie. — Mbeti çizmja. Të rruat qafa që ke në dorë. (F. Gjata, Brezat, 201);

— *keqardhje*, — *Oh*, si s'durove gjer të enjten! (Dh. Xhuvani, Kam-bana, 18);

— *mosbesim*, — Do t'ja mbushim mendjen edhe xha Rexhepit. *Oh!* e ku i mbushet mendja atij! (A. A. Mara, Brumi, 50);

— *pikëllim*, — *Oh!* — thonë vashat të pikëlluara, — gjersa të shkrijë lumi dhe të hapen kronjtë, do të na ngordhë tërë gjëja e gjallë. (M. Kunteli, Tregime, 93).

Mimika dhe gjestet që shoqërojnë herë-herë këto pasthirrma vetëm pjesërisht plotësojnë aftësinë shprehëse të tyre. Shenjat e pikësimit, dyfishimi ose shumëfishimi i shkronjave të një pasthirrme a i një pasthirrme të tërë vetëm në një shkallë të vogël pasqyrojnë veçoritë e intonacionit të një pasthirrme të dhënë. P.sh.

— *A! A! A!* Ta thashë. Të paralojmërova, shok, Mos më sulmo! (P. Marko, Hasta, 105); Dom Gjoni; *Aa...* tashti filloi avazi i gjatë. Dëgjo! (K. Jakova, Dom Gjoni, 45); — *Oo*, kapeni, katilin, kapeni Mitron, Na e vrau Nelon! — u dëgjua zëri i egërsuar i xha Shemos. (S. Spasse, Afërdita përsëri, 259); Vasifi: *Ooooo!*... I dashuri dhe i shtrenjë Kosta! (S. Çomora, Nga fshati, 36); *Oh! Oh!* iu shmangej nga gjoksi i kënaqun tue andrrua të korrnat e ardhshme. (Migjeni, Novelza, 146); — *Oh...*

Oh... Oh... — kënaqej Kasemi. — Kjo është jetë!... (B: Lëvonja, Ditari, 35); — *Pu, pu, pu*, moj bijë. Po ç'a themi në plakat që bota u prish sot! (J. Xoxa, Juga, I, 99); Afroviti — Apo s'u kundërmonte trupi! Olimbia — Mos m'i kujto! *Pupupupupu!* (S. Çomora, Karnavalet, 164).

E njëjta pasthirrmë mund të shprehë bashkë me kontekstin ndjenja të ndryshme, por ndodh edhe e kundërta: pasthirrma të ndryshme mund të përdoren për të shprehur të njëjtën ndjenjë. Kështu, për të shprehur ndjenjën e gëzimit mund të përdoren pasthirrmat *ah, hej, o, oh, oho, uh, urra* etj. ndërsa për të shprehur ndjenjën e habisë mund të përdoren pasthirrmat *a, ah, bre, bobo, korba, oj, pupu, qyqja, u, ua, uh* etj. P.sh.

a) *gëzim*:

Ah, sa mirë keni bërë baba! Ruzhdiu fërkoj duart me gëzim dhe tha: — *Hej*, çdo të kërcasë; (A. Kristo, Shkëndijat, 589); — *O*, sa mirë! Me dru rin e këtij lisi mund të ndërtojmë të gjitha shtëpitë e reja të fshatit, — tha e gëzuar dhe u afrua te lisi për të nisur punën. (B. Gaçe, Shtëpia, 3); *Oh, ç'gëzim!* E mbaj mend si tashi: atë letër ma kishte dhënë Agron Omiri. (J. Xoxa, Juga, II, 22); — *Oho*, sa mirë që s'do të kemi shkollë! (A. Kristo, Shkëndijat, 379); *Uh*, ty të lumtë, more biri jem! — bërtiti prej gëzimit djalli i madh. (A. J. Rrota, Rreth Votrës, Legjenda e shtypit, 93, 1945); *Urra!* — bërtiti pa dashje nga gëzimi Loku në radio. (I. Spasse, Cuca, 20);

b) *habi*:

— *A*, kush qenka, çuni Janit. (A. Abdihoxa, Ëndërra, 102); *Ah!* Ti më qënke! Ku të kam parë unë ty? (F. Gjata, Tana, 46); — *Bre!* sa të ngjet, moj Mrikë! U çudit nusja më e madhe, duke i treguar fotografinë së voglës, dhe unë shtanga. (Dh. Shuteriqi, Kënga, 319); *Bobo*, ç'dasmë paska qënë! (M. Kuteli, Xinxifilua, 113); Olimbia, Ishin shumë? Nikollaqi — *Oj*, ishin thotë! Sa të duash. (S. Çomora, Drama, 166); *Pupu*, sa e bukur! Shiko, shiko si ndrit «fap, fap». (M. Zaloshnja, Nën hijen, 60); Ne plaka erdhi: — *Qyqja, qyqja*. Ç'qenkan gjithë kto bukuri shpijash që nuk paskan ngrysë e paskan gdhi! (Folklor shqiptar, Proza, III, 304); — *U*, mësuesi, mezi të njoha — thirri ai dhe u përqaftuan. (D. Agolli, Komisari, 115); — *Uh!* — tha e habitur. — Hyri në shtëpinë e braktisur të plakës Xhevrije! (T. Laço, Toka e ashpër, 151);

Veç pasthirrmave me kuptim të paqëndrueshëm, vlera e të cilave përcaktohet nga konteksti e intonacioni, shqipja ka edhe pasthirrma me kuptim pak a shumë të qëndrueshëm e të përcaktuar, vlera e të cilave, si të thuash, s'varet aq shumë nga konteksti. Pasthirrma të tilla në gjuhën shqipe, ndërmjet të tjerave, janë: *bobo, bubu, upupu, opopo* (frikë, tmerr); *u, ua, oj* (habi) etj. Por me kuptim më të qëndrueshëm e më të përcaktuar paraqiten sidomos pasthirrmat urdhërore: *hë, hop* (nxitje); *sus, shët* (qetësi, hesht); *eja* (urdhër); *ore, more, moj* (thirrje) etj.

Pa dyshim, është e vështirë që duke u mbështetur në kuptimin e pasthirrmave, të bëjmë një ndarje të hollësishme e sa më të përcaktuar të tyre në grupe. Dy janë vështirësitë kryesore: së pari, pasthirrmat, zakonisht, nuk shërbejnë për të shprehur vetëm një ndjenjë, por disa dhe nga më të ndryshmet, mjafton të shqiptohen me intonacionin përkatës, në varësi nga rrethanat e të folurit dhe konteksti; së dyti, shpesh

nuk është e mundur të përcaktojmë me siguri se për cilën ndjenjë pikërisht përdoret më tepër pasthirrma e dhënë. Nuk është e rastit, p.sh., që, ndërmjet të tjerave, pasthirrmat *ah* dhe *oh* K. Kristoforidhi⁴⁵ i vlerëson *indinjuese*, *Koço Tasi*⁴⁶ i quan *vajake*, ndërsa për *Petër Elezin* dhe *Lirak Dodbibën* janë pasthirrma që tregojnë *pikëllim* ose *mërzi*. Megjithatë, duke marrë parasysh se për cilat ndjenja përdoren më tepër, si në gjuhën e folur ashtu edhe në letërsinë artistike, pasthirrmat emocionale mund të ndahen në disa nëngrupe: 1) *pasthirrma që shprehin ndjenja të gëzueshme*, 2) *pasthirrma që shprehin habi*, 3) *pasthirrma që shprehin frikë*, *tmerr*, 4) *pasthirrma që shprehin mospërfillje*, *përbuzje*, 5) *pasthirrma që shprehin dhimbje*, *dëshpërim*, 6) *pasthirrma që shprehin kundërshtim*, *mosbesim*.

Natyrisht kufiri që ndan pasthirrmat e njërit nëngrup nga ato të nëngrupeve të tjera, nuk është i pakapërcyeshëm, derisa e njëjta pasthirrmë, në varësi nga intonacioni me të cilin shqiptohet dhe konteksti a rrethanat e të folurit, mund të shprehë ndjenja nga më të ndryshmet. Prandaj, krahas të tjerave, për çdo pasthirrmë të nëngrupit përkatës, jemi përpjekur të vëmë në dukje jo vetëm ndjenjat që shprehin më shumë, por edhe ndjenjat e nuancat e tjera përkatëse, që, ndonse zakonisht më rrallë, i gjejmë si në gjuhën e folur ashtu edhe në letërsinë artistike.

1. *Pasthirrma që shprehin ndjenja të gëzueshme* (gëzim, kënaqësi, entuziazëm, etj.) janë: *o*, *oh*, *oho*, *hoho*, *ohoho*.

O

Kjo pasthirrmë është mjaft e larmishme në përdorim. Mund të përdoret për të shprehur jo vetëm ndjenja të gëzueshme, por edhe ndjenja të tjera, sidomos *habi*, *mospërfillje*, *përbuzje*, *zemërim*, *pakënaqësi* etj. P.sh.

O, mirse na erdhët, mirse na erdhët, sot do të dëgjojmë Merushen se si do të na flasë për aksionin, do të shikojmë edhe Dëshpërimen në skenë. (I. Spasse, Cuca, 103); Në hajat u dëgjuan hapa. Zylua u ngrit e hapi derën. — *O*, hajde Hodo Allamani, hajde — thirri. (D. Agolli, Komisari, 193); *O*, pa shiko, paskemi miq në shtëpi. (A. Cerga, Bukuria, 117); — *O*, ti qënke! — tha Syrja agai me një fije zëri, kur njohu fytirën e Batos. (P. Jusufi, Përrenjtë, 129); — *O*, po ç'është kështu me ty! — e ngacmoi njëherë një moshatar — Që kur t'u plak gruaja, e ke hedhur të tërë dashurinë në lulet. (Th. Noti, Në gjirin, 106); — *O*, na bëre për të qeshur, s'e sheh, a! Do trembte lugati lugatin. (P. Isufi, Përrenjtë, 5); — *O*, gjë të bukur fort bëri, s'e sheh, a! Aferim i qoftë! — shfryu plaku dhe nisi të mbushte çibukun. (P. Jusufi, Përrenjtë, 7); — *Oo*, me të qarë! Është ndaluar e qara... (V. Sejko, Ngjarje, 43); *O*, ç'burrë, më dashke dhe nuse, pale. (S. Pitarka, Heronjtë, 11); — *O*, dhe ju heshtët përballë një falsifikimi të tillë, falsifikim që ju vë damkën e tradhëtisë ndaj atdheut? (P. Jusufi, Përrenjtë, 153).

45) K. Kristoforidhi, *vepër e cituar*, f. 165.

46) Koço Tasi, *vepër e cituar*, f. 12.

OH

Pasthirrma *oh* (me zanore të shkurtër) shërben për të shprehur gëzim, kënaqësi, entusiazëm, admirim, mirënjohje, P.sh.

Oh Shpresa, sa po gëzohem që... deshi me i than: «që po të takoj», po tue e dit se ai e kishte takue tash dy tri orë, vazhdoi me shaka — që paske zhdukë ato pika mbi hundë, që të tregonin si ndonjë çamarok! (F. Ndocaj, Diell, 334); — Sa mirë, *oh*, sa mirë që na erdhi përsëri! — thoshte këto fjalë me duf të mbytur e me ngulçim duke u përshëndetur me Afërditën. (S. Spasse, Afërdita përsëri, 4); Pa le ai trimi, ai Stefan Gjoka, që kemi njohur në Devoll, kur u hap kanali! *Oh!* ç'bënte ai! (F. Gjata, Tana, 53); — Si ndjehesh, xhan? — foli mamia. — *Oh*, fare mirë. Do të ma sjellin sot vajzën? (E. Kadare, Një lindje, 235);

Por, në varësi nga konteksti dhe intonacioni, me këtë pasthirrmë mund të shprehim edhe një sërë ndjenjash të tjera sidomos zemërim, pakënaqësi, keqardhje, habi, vendosmëri, dhimbje, dëshpërim, frikë. P.sh.

Oh, kjo Verka! Ç'i thotë mendja vallë? Tërë vetë kërkon t'i bëjë! (P. Zoto, Verka, 49); *Oh!* Ti gjithnjë s'hoqe dorë nga këto. (Z. Sako, Nga jeta, 21); — Si të duket, do ta bësh dot? — *Oh*, pa dyshim! (A. Kristo, Shkëndijat, 427); — *Oh*, sa i çuditshëm. Edhe ti shok je. (P. Marko, Stina, 422); Kur u ndanë, oh, nuk dua ta kujtoj!... (P. Marko, Hasta, 398); ... *Oh*, nuk due të rroj ma... (S. Pitarka, Trimi i mirë, 42); *Oh*, ajo andërr e llahtarshme që pashë... (N. Sinaeri, Kokrra, 45);

Këtë pasthirrmë folësi e përdor shpesh kur kujtohet për diçka. Edhe në këtë rast pasthirrma shoqërohet me ndonjë ndjenjë, sidomos keqardhje ose kënaqësi. P.sh. *Oh*, se mënd harrova, — u kujtua plakun. — Të lumtë ty, bir-o! Takohemi tek lugu i Mëshqetës. (Pionieri, 1, 1973).

OHO, HOHO, OHOHO

Këto pasthirrma përdoren zakonisht për të shprehur gëzim, kënaqësi, entusiazëm, P.sh.:

Skënderi, tha: — *Oho*, sa mirë që s'do të kemi shkollë. (A. Kristo, Shkëndijat, 379); *Oho!*... Sa mirë, sa mirë që këndonin e kërcenin, o këmbëshpejtë të pyllit. (Ç. Ruhi, Sorkadhja, 20); *Oho, oho!* Duallën! Duallën! — brohoritën të rinjtë sa i panë e dikush pyeti... (I. Spasse, Cuca, 114); «— Ç'ja paskanë punuar! *Oho*, më u lumtë!» (S. Spasse, Afërdita përsëri, 12);

— *Ohohooo!* — klithi përsëri Samiu dhe zuri të fërkonte duart i gëzuar... (P. Jusufi, Përrënjtë, 51); *Ohoho!* — thirrri ai i kënaqur — këtu kam me se të ngopem — dhe u ul mbi një dhëmballë të madhe të nofullës së poshtme e filloi të hante. (Fatosi, 1, 1973); Kur është vapë e kur fryn erë *Ohoho*, sa më shijon! (Yllkat, 4, 1971). Pasthirrma *hoho* ka përdorim më të kufizuar, si në gjuhën e folur ashtu edhe në letërsinë artistike.

Në disa raste pasthirrmën *oho* e kemi ndeshur edhe për ndonjë ndjenjë tjetër, sidomos habi, përbuzje e ironi. P.sh.

— *Oho*, u habit Sulua. S'ndizen kaq de. (F. Gjata, Përmbysja, 374); — *Oho*, Merushe, më qënke bërë, mashalla rruncë! (S. Spasse, Afërdita

përsëri, 64); — *Oho*, ç'na bëre të qeshim. Jo, more Artan nuk të pyeta për atë.

— *Oho*, qenke bërë edhe orator, pa le! Mos i bëj bish pyetjes sime i hoqi vërejtjen ajo. (S. Spasse, Zjarre, 299).

2/ Pasthirrma që shprehin habi janë: *áu, eu, ë, oj, óu, pa, (pah), py, u, uj, uh*.

AU

Kjo pasthirrmë përdoret jo vetëm për të shprehur habi, por edhe ndjenja të tjera, sidomos dhimbje, dëshpërim, keqardhje, frikë, gëzim, kënaqësi etj. P.sh.:

— *Au!* Si, qenke memec e ditke të flasësh? Çfarë numri. (A. Cerga, Bukuria, 100); — *Po, Shpresë, Diella!* . . . Ajo priti, mbrëmë. — *Au!* (J. Xoxa, Juga, 344); — *Au*, sa u tremba! thirri Qamilja dhe po i dridheshin gjunjët. (M. Zaloshnja Lugetët, 124); Katundarët: (me gëzim) *Au!* Sokoli. — K. Jakova, Dom Gjoni, 59).

EU (HEU)

Kjo pasthirrmë përdoret për të shprehur kryesisht habi, por mund të përdoret për të shprehur edhe ndonjë ndjenjë tjetër, si dëshpërim e dhimbje, sidomos në gegërishten, ku kjo pasthirrmë është më e përhapur, P.sh.

— *Eu*, si qenka djegur xhani! (P. Isufi, Përrenjtë, 121); *Po*, kur pa pranë votrës një keç që po e piqnin në hell s'ju durue pa thanë! — *Eu*, po a për mue e keni shkue dam qat ftujak, a? (F. Ndocaj, Diell, 113); — *Heu!* Banë njizani, me habi, të tanë minatorët. (M. Gurakuqi, Minjera, 19); — *Heeeu!* — u përplas qoshe më qoshe luginës së gjerë një jehonë e dallgëzuar habie. (P. Jusufi, Përrenjtë, 138). *Heu* unë e mjera, — thashë me vete si më turpnoi sot. (K. Jakova, Fshat, 89).

Ë

Pasthirrmën *ë* e ndeshim rrallë në letërsinë artistike, por në gjuhën e folur, në thjeshtligjërime, ka përdorim më të gjerë e më të larmishëm. E gjejmë për të shprehur habi, frikë, mosbesim, përbuzje, kërcënim, kënaqësi, P.sh.:

Le që vajza ka për ta gjetë vetë burrin. — *Ë!* Tobe stafkurulla! Lojti plaka nga vendi. (Dh. Shuteriqi, Çlirimtarët, II, 161); — *Ëëë*, e dij se ç'është ajo! — u zgërdhi për së dyti teto Kata. (S. Spasse, Afërdita, 98); «Kij mendjen, *ë!* Se mos janë ilaçet të skadueme. . . e di vetë ti!» (Sh. Musaraj, Para, I, 104); — Ja dha që ç'ke me të, mu përpara nesh dhe xixa i duallën nga sytë gjermanit. «*Ë*, ç'ja bëri» — u çfrynë të gjithë. (S. Spasse, Afërdita përsëri, 17).

SHENIM: Fjala *ë* mund të përdoret edhe si pjesëz pyetëse, sidomos kur ndodhet në fund të një fjalie me anën e së cilës kërkohet përgjigje, ose si pjesëz pohimi. Si pjesëz pyetëse, sidomos kur ndodhet në fund të një fjalie, kuptimi pyetës i saj gërshetohet edhe me ndonjë nuancë emocionale, në varësi nga intonacioni e konteksti (sidomos kërcënim, zemërim, përbuzje, ironi etj.) P.sh.

Më tha pastaj Stefania. . . që festoni ditëlindjen. . . Stefania — *Ë*. . .

ë... unë i thashë vërtet! (T. Laço, Drama, 51); Po si thua ti, si del para-
raja, këput fiq e ha, ë? (T. Laço, Rruga, 139).

Oj

Kjo pasthirrmë është shumë e përhapur si në gjuhën e folur ashtu edhe në letërsinë artistike. E ndeshim për të shprehur kryesisht habi. P.sh.

— Prit të ta shoh edhe unë një herë. *Oj!* Vërtet paske një pikëz. Kam kaq kohë që nuk e kam vënë re. (A. Cerga, Dritë, 80); — *Oj*, pa dale! u çudit Murati duke e shtyrë me sa fuqi atë që deshi të hyjë i pari. — Ç'është kjo qeveri? (A. Abdihojha, Një vjeshtë, 114); Olimbia — Ishim shumë? Nikollaqi — *Oj*, ishin thotë! Sa të duash. (S. Çomora, Karnavalet, 166).

OU

Pasthirrma *ou* përdoret zakonisht për të shprehur habi, shpesh e gërshtuar edhe me ndonjë nuancë tjetër emocionale, sidomos përbuzje, mos-përfillje, ironi e gëzim. Në ndonjë rast përdoret për të shprehur dhimbje a dëshpërim, ose si përgjigje ndaj një thirrjeje. P.sh.

— *Ou*, paskeni ardhur edhe juve sonte këtu? (I. Spasse, Cuca, 61); — *Ou!* Ja paske shtruar, Veli? (A. Abdihojha, Tri ngjyrat, 68); — Pse kush nuk është me Partinë? — Sulltani. — *Ou!* Ajo dihet. (F. Gjata, Përmbyssa, 204); Evanthia — Po jo kështu se merrni plevitin. Si ka thënë perëndia: «Ruaju, të të ruaj». Hëna — *Ou!* Po qe për perëndinë... (A. Mamaqi, Për kujtim, Pjesë teatrale); Nasi u zgjua me një rënkim. Pastaj e dëgjova që thirri tëmën: «Nëno, moj!» — *Ou*, u përgjigj plaka nga brenda. (Dh. Shuteriqi, Tregime, 369).

PA (PAH)

Përdoret kryesisht në thjeshtligjërim dhe për të shprehur habi. Në letërsinë artistike e kemi ndeshur rrallë. P.sh.

— *Pa!* Të fortin zâ paska! t'ikim, se ai do të jetë i fortë edhe me trup! (Prralla kombtare, I, Shkodër, 1942, 158); Ç'e do! E diç unë se si do t'i përgjigjesha, por asht grue. *Pah*, zevzeke që qënka! (Gj. Daka, Vath, 26); *Pah*, sa i shijshëm qe bërë! (K. Blushi, Drama, 195).

Kjo pasthirrmë përdoret edhe e përsëritur. Në këtë formë shpreh jo vetëm habi, por edhe ndonjë ndjenjë tjetër, sidomos zemërim, indinjim, përbuzje, frikë, tmerr e kundërshtim. P.sh.

Por kjo mënyrë të foluri e zemëroi më shumë vajzën. — C'mustaqe-llin sedërmëdhenj! — tha ajo e papërmëbajtur. — Turp t'ju vijë. Edhe ty Fadil që rri atje si llosh, turp të të vijë. *Pa-pa-pa* ç'njerëz. (E. Kadare, Një lindje, 216); — Demonstratë? — *Pa-pa-pa* — tha Petro Paskali. — Më mirë na thoni të hidhemi në lumë! (A. Kristo, Shkëndijat, 95); — *Pa-pa-pa!* S'bahet llaf me te! — thonin djemuria. (I. Spasse, Cuca, 66).

PY

Kjo pasthirrmë ka përdorim të kufizuar si në gjuhën e folur, ashtu edhe në letërsinë artistike. Përdoret kryesisht për të shprehur habi a për të nënvizuar mendimin e shprehur nga fjalja pranë së cilës qëndron. Shqiptohet me zanore të zgjatur. P.sh.

Pyyyy si më duket bota! (A. Kristo; Shkëndijat, 48); *Pyyyy!* ç'tanks, bre, kanë pasë ata të lagjes VII! (S. Vagarrri, Përpara për Berlin, 11, 1947).

U

Pasthirrma *u* përdoret gjerësisht, si në gjuhën e folur ashtu edhe në letërsinë artistike, për të shprehur zakonisht habi. P.sh.

E si ta kanë vjedhur çfarë? — *U!* Pse pakë të duket ty. (N. Prifti, Lëkura, 14); — *U*, mësuesi! Mezi të njoha — thirrri ai dhe të dy u për-qafuan. (D. Agolli, Komisari, 115); — *U!* Po ti nga na dole? Na i bëre sytë ujë. (A. Kristo, Shkëndijat, 419).

Kjo pasthirrmë përdoret për të shprehur edhe ndjenja të tjera, sidomos keqardhje, dhimbje, dëshpërim, zemërim, përbuzje, frikë, si dhe për të nënvizuar anën emocionale të fjalisë pranë së cilës qëndron. P.sh.

— *U*, më rëntë pika që s'e njoha! tha plaka dhe e zuri për qafe Memon. (D. Agolli, Komisari, 24); — *U*, biri i nënës, bir! Kush do të ta marrë hakun! — vajtonte plaka, duke i rënë përsipër Mëmos. (D. Agolli, Komisari, 72); — *U!* Më martë të keqen e m'u bëftë kurban far'e fis i tia e mban' ku jân'. (A. Asllani, Hanko-Halla, 181); — *U u u*, kush na qenka bërë prefekt! — tha ajo me një ton përbuzës. (A. Kristo, Shkëndijat, 503); *U*, sa më trembe! (D. Agolli, Shkëlqimi, 190).

UA

Kjo pasthirrmë përdoret gjerësisht, si në gjuhën e folur ashtu edhe në atë të shkruarën. Përdoret zakonisht për të shprehur habi, por në disa raste e kemi ndeshur edhe për ndonjë ndjenjë tjetër, sidomos për të shprehur frikë, tmerr. P.sh.

— *Ua, ua*, ç'ja paskan punuar, bre! — ja bënë të tre fëmijët me nxënësit që u patën grumbulluar aty, kur ua tregonte zonjusha prrallën. (S. Spasse, Afërdita përsëri, 11); Mërziti ju vajzat — pyeti Memua. — *Ua*, ne jemi shumë të gëzuara tha Alma me faqe të skuqura nga thellimi dhe emocioni i këtij takimi. (D. Agolli, Komisari, 288); — *Ua*, si të shihet ai ty. Dukej sheshit që ta kishte vënë synë. (E. Kadare, Një lindje, 39); — *Ua, ua!* Ulu se të panë! — tha Lola. (P. Zoto, Verka, 83); Derën e apartamentit e hapi Mira. — *Ua*, — ia bëri ajo e tmerruar. (I. Kadare, Dimri, 271).

UH

Është një nga pasthirrmat me përdorim mjaft të gjerë e të larmishëm, si në gjuhën e folur ashtu edhe në letërsinë artistike. E ndeshim zakonisht për të shprehur habi. P.sh.

Uh! U habit Nevruzi. Ç'domethënë kjo, je apo s'je gruaja ime? (N. Prifti, Martesa e Dizit, Drita, 12.3.1967); Pirua — Jo, nuk e di. Marina — *Uh*, po atë e dinë të gjithë! (L. Papa, Drama, 97); Kalon katundari e sheh. — *Uh!* dhelrna — thotë me të bindun. — Paska cofë e shkreta. Rreziku i saj, nafaka e eme. (Folklor, I, Proza, 54).

Kjo pasthirrmë është sinonime me pasthirrmën *u* edhe kur shërben për të shprehur ndjenja të tjera: keqardhje, dhimbje, dëshpërim, zemërim, frikë, përbuzje etj. Por pasthirrma *uh*, ndryshe nga pasthirrma *u*, përdoret gjerësisht për të shprehur edhe pakënaqësi, mërzë, lodhje shpirtërore, herë-herë, lehtësim. Në këtë përdorim pasthirrma *uh* është sinonime me pasthirrmën *uf*. P.sh.

— Po tranzistorin e fute në valixhe? — *uh*, harrova! — thirrri Adili.

(D. Agolli, Shkëlqimi, 76); *Uh*, moj nanë! ... Me e dijtë ti, sa keq jam tash, e sa e idhtë kenka jeta pa ty! ... (J. Rrota, Rreth votrës, 40, 1945); *Uh!* Kokëtulja! Tani ma thotë! ... (S. Pitarka, Familja, 33); — *Uh*, sa më trëmbë! mori frymë lirisht vjehra. (S. Spasse, Kurora, 137); — *Uh*, ngadalë, ngadale! S'paska pranuar! Çuditë me ty Zaim Avazi. Je kritik dhe të mungon zgjuarsia! tha Kleopatra. (D. Agolli, Shkëlqimi, 195); Kur erdhën kto te dera, kjo ju doli përpara, hysmeqarja e thurret: — Hanëm, hanëm, po të thurret begu. — *Uh*, si e ka ma këtë punë ky. (Folklor shqiptar, Proza, III, 500).

UJ

Ka përdorim të kufizuar dhe kryesisht në thjeshtligjërime dhe në të folmet e Shqipërisë së jugut. Në letërsinë artistike ndeshet rrallë. P.sh.

— Pse e paskë lënë burrin ti? pyeti pa dashje ajo. — *Uj* të lënë, e çfarë të lënë se! (I. Spasse, Cuca, 81); — Do të vini në qytet? — *Uj*, posi, për atje presim, ja pa shih. (K. Kosta, Bisedë, 141-142).

3) *Pasthirrma* që shprehin frikë, tmerr janë: *bo, bobo, obobo, popo, opopo, bu, bubu, ububu, pu, pupu, upupu, korba, kuku, qyqja, lele (olele), e zeza, o zot*. Këto pasthirrma përdoren për të shprehur edhe ndonjë ndjenjë tjetër, sidomos dhimbje, hidhërim, dëshpërim. Disa, sidomos, *bobo, obobo, bubu, ububu, popo, opopo, pupu, upupu* përdoren herë-herë për të shprehur habi e intensitet. Pasthirrmat *korba* e *qyqja* përdoren nga gratë dhe vajzat. Pasthirrma *korba* përdoret kryesisht në toshtërishten letrare, ndërsa *qyqja* e *kuku* përdoren kryesisht në gegërishten letrare. Në krahësim me *bobo, obobo, bubu, ububu* format *popo, opopo* kanë përdorim më të kufizuar, kryesisht në toshtërishten letrare. Format *bo, po, bu, pu (puh)* në gjuhën e folur ndeshen shumë rrallë, ndërsa në letërsinë artistike thuajse s'përdoren fare. P.sh.

BO, BOBO, OBOBO, POPO, OPOPO

I thërret topuzit «Vur topus » i thotë. E zë ay topuzi këtë bamp! bump! — *Bo* — thotë — më vrau! (Folklor shqiptar, Proza, III, 124); Ka nga ata që lëngojnë në kazanë, që ziejnë në serë. — *Bobo!* (P. Marko, Urata, 20); Tina dolli nga dhoma e menduar dhe e dëshpëruar: *Bobo*, do të jetë gënjer korba! — bëlbëzoi me zë të mbytur. (S. Spasse, Afërdita përsëri, 180); Qaj, o Nivica ndë grykë, *Bobo!* sec' qe ajo ditë, që t'u bënë hasëm dhe miqtë. (Mbledhës, 136); Talleshin pogradecarët me mua. Njeri thoshte: *Bobo* ç'gurneckë! Sa një krap! Sa një krap!» (Dh. Shuteriqi, Gurneckë, 21); Fëmija — *Obobo*, unë kam frikë. (L. Papa; Drama, 92); *Obobo!* sytë ç'më panë! Tha Mitkua si i marrë. Pashë gruan me jaranë. (A. Z. Çajupi, Baba-Tomorri, 80); — *Obobo*, ne të mjerat! Po hap gojën e kërko, moj Xëme. (M. Kuteli, Netë, 146); Ua sa i bukur! Po këto vëthka? Yt kunat? *Obobo* sa të bukura. (Folklor shqiptar, I, Durrës, 1936, 13); ... *po-po*, u er e më z mbrëma, e do më qërtonjë mëma. (Mbledhës, I, 482); — *Opopo!* — briti. — Eja këtu, bijë! (Gj. Zheji, Pupagjeli, 56).

BU, BUBU, UBUBU, PU (PUH), PUPU, UPUPU

Bu, se ha dot një turp të tillë! — arsyetonin gratë. (S. Spasse, Afërdita përsëri, 217) — *Korba* Miti llafazani e kishte parë Gjergjin e Kaçorrajve

ta ndukte e ta puthte si grua Marinën e Gurrëmadhit. *Bubu*, u plasi cipa fare. (S. Spasse, Buzë, 35); Bota pa na parë fare, nxjerrin një kosh fjalë, pa le sikur të na shohin. *Ububu!* Mirë bëra që ika. (S. Spasse, Buzë, 100); *Ububu!* nënoceja ime, ç'pashë sonëte nd'ëndërë, sikur më nise, më stolise, e më dhe një dhëndërë. (Mbledhës, 62); *Puh*, ç'gënjen maskarai. (L. Papa, Drama, 87); Me të dyja duart çirte faqet: — Mos hyni! Do t'ju gjejë baba! *Pupu!* (D. Agolli, Komisari, 91); *Pupu*, si qënke bërë, mashalla, — i tha dhe ja ligaviti faqet. (S. Spasse, Buzë, 168); — *Upupuuu* sa gomarë! — tha Ristua. — Pse kaq shumë gomarë ka vendi ynë? (A. Kristo, Shkëndija t, 21).

KORBA

Dera e udhës trokiti. — *Korba!* u drithtue plaka dhe u gjet në këmbë. (Dh. Shuteriqi, Çlirimtarët, I, 15); Andrea — E ç'do të ndodhte? Mua asgjë, po Stafos i iku vajza me një shofer... Dhimitra — *Korba!* (T. Laço, Drama, 27); *Korba-korba*. Një jetë e tërë në këtë shtëpi. (D. Shaplo, Kohë, 28); *Korba-korba*, të kanë marrë më sysh! (S. Spasse, Afërdita, 132); — *Korba!* Edhe ju çupat? kish bërë çudi Nadireja. (Dh. Shuteriqi, Çlirimtarët, 207).

KUKU

— *Kuku*, ça jam frigue! — tha Terezina, duke lidhur duart mbi kraharor. Ishte dicka e mnershme. (V. Kokona, Me valët, 264); Plaku i ra kokës me grushte. — *Kuku* — thirri, — *kuku!* Tash po më vritet! Ai asht fëmi. (S. Drini, Do të luajmë, 97); Pas zakonit e nderuam: Me plumb ballit e martuam! — *Kuku*, nane, at' far' djalit: «Me plumb ballit» (A. Varfi, Dielli, 71); — Dhe unë kujtoja se atë gjëmë ma bënë partizanët! *Kuku!* Nanë! Më lëshoni, bre, në kini besuar perëndi. (P. Marko, Stina, 515); Terezina ja krisi gazit dhe si i dha fund të qeshurit, tha duke vënë duart në ije: — *Kuku*, ça kam qeshë! (V. Kokona, Me valët, 263).

QYQJA

— *Qyqja*, ç'bëmë ne, *qyqja!* Therëm kaun! — dhe si e çmendur, doli nga plevica duke shkukur flokët. (S. Spasse, Buzë, 280); Mrika: Ashtu, e? *Qyqja qyqja*, e mjera unë e mjera! (K. Jakova, Dom Gjoni, 10); Them të të veshim, Zare, me roba ushtarake! Ajo hapi sytë dhe thirri me zë të vogël: — *Qyqja* si të vishem unë ashtu! (N. Jorgaqi, Posta, 106); — *Qyqja*, ç'e bukur qeka: e si s'e dashka çun'i mretit. (Pralla popullore, T. 1950-1951, II).

LELE (OLELE)

Përdoret në thjeshtligjërime, kryesisht në gjuhën femënore. Ka përdorim të kufizuar, sidomos në letërsinë artistike. P.sh.

Lele sikur të kishte humbur çupa, do të më kishte vrarë ay i zi. (Th. Kacori, Për mëmëdhenë, 251); *Le-le*, tundin dheun, kur ecin. (S. Spase, Ata nuk ishin, 82); — *Olele*, më vrau! — klithi ajo tërë llahtar. (S. Spasse, Buzë, 278); — *O lele*, Nëno... Ngjelina... (M. Kuteli, Netë, 62).

E ZEZA

E ëma — (e trembur seriozisht) *E zeza!* Ti po flet përçart. (K. Blushi, Drama, 204); Në koridor u ndjenë thirrje: — *E zeza, babai!* — E zeza, babai! (D. Agolli, Shkëlqimi, 53); Në çastin tjetër dëgjova zërin e Evanthisë. — *E zeza*, qenka vrarë Marko Qazimi, (S. Godo, Zëra, 52).

O ZOT

Kjo pasthirrmë, me origjinë emërore, në krahasim me sinonimen e saj *o perëndi* ka përdorim më të gjerë.

— Mbrëmë kujtova se u shemb bote. Sa natë e errët! Ata topa që gjëmonin! O zot, thashë me vete, ç'shtë kështu? Pastaj... pastaj ato që më dëgjuan veshët për time bijë. (A. Abdihoxa, Tri ngjyrat, 228); *O zot!* thirri Merjemeja, duke zënë kokën me duar. — Dysheku bosh! Ku të ketë shkuar? (Q. Buxheli, Kali i mbretit, 70); *O zot*, po ky ka vdekur, qysh erdhi te porta? (N. Prifti, Çezma e floritit, 28); — *O zot, o zot*, dhe këtu më gjete! Folklor shqiptar, Proza, III, 218).

3) *Pasthirrma që shërbejnë për të shprehur mospërfillje, përbuzje janë amá, aá (ahá, ahúá, ahúhā), eá (ehá, ehúá, ehúhā), í (ih), oá (ohá, ohúá ohúhā), ptu, y (hy)*. Që të gjitha këto pasthirrma, në varësi nga intonacioni e konteksti mund të shërbejnë për të shprehur edhe ndjenja e nuanca të tjera emocionale.

AMA

Pasthirrmë me përdorim të gjerë e të larmishëm, si në gjuhën e folur ashtu edhe në atë të shkruarën. E gjejmë për të shprehur jo vetëm mospërfillje e përbuzje, por edhe ndjenja të tjera, sidomos për të shprehur mburrje, kërcënim, ironi. P.sh.

Ama kryetar paski! (F. Gjata, Tana, 111); Petriti u ngrit në këmbë: — *Ama*, atij rrebeshi i trembesh ti? — pyeti ai me djallëzi. (A. Abdihoxa, Një vjeshtë, 66); — *Ama*, të vrarë i kishe bërë, o Nasi, — u tall ai dhe i ra shokut me grusht në kurriz. (F. Gjata, Në pragun, 55); — Këtu jam unë i parë. Rri urtë ashtu siç ndejta edhe unë në mbledhje. — *Ama*, urtë ndejte! — e thumboi Bardhuli. (A. Abdihoxa, Një vjeshtë, 114); *Ama* që për kokën e qeve! (F. Gjata, Tana, 89); Dëgjo! Do të të tregoj diçka për një djalë... *Ama*, po hape gojën, do të të bëj copë me shatë. (F. Gjata, Brezat, 88); — *Ama*, ç'muhabet që po bëhet ua preu Pucelli, — sikur s'je në këtë dynja. (P. Marko, Hasta, 408).

AU (AHU, AHUA, AHUHA)

Kjo pasthirrmë në të gjitha format e saj ndeshet më pak, si në gjuhën e folur ashtu edhe në letërsinë artistike, në krahasim me sinonimet e saj *eú, (ehú, ehúá, ehúhā)* dhe *oá (ohú, ohúhā)*. Në letërsinë artistike pasthirrma *au*, në të gjitha format e saj, ndeshet shumë rrallë, ndërsa në gjuhën e folur ka një farë përdorimi, sidomos në formën *ahu*. P.sh.

... e pse tamam Dudijen? Le të loste me... *Au!* Ç'them edhe unë! Gjepura. (T. Laço, Nëntori, 140, 12, 1971); — Ka shumë — tha ajo — nuk mund ta prish. — A ka mundësi ta matim? e pyeta. — *Auuu!!* ... (Puna, 22 gusht 1972, 2); — Do t'ia shikojmë bythën edhe atij, në behar,

se ortakëve *ahu* ku u rreh mendja atyre... foli xha Vasili, djali i madh i Kol Shpërvjelit. (J. Xoxa, Lumi, I, 100); — *Ahu!*... Ti shoqja agronome thua të numërojmë edhe thelat e bostanit. (J. Xoxa, Juga, 247); — *Ahua*, sa larg paske mbetur, or burrrë! Gjezdise dynjanë dhe akoma te ura. (M. Kallamata, Netë, 62); — *Ahuha*, na fute në të thella; bëj ç'të duash; (R. Nepravishta, Pelikanët, II, 147).

EU (EHU, EHUA, AHUHA)

Përdorim më të gjerë, si në gjuhën e folur ashtu edhe në letërsinë artistike kanë format *eu* dhe *ehu*, të cilat shërbejnë për të shprehur jo vetëm mospërfillje e përbuzje, por edhe ndonjë ndjenjë tjetër, sidomos zemërim, pakënaqësi. Format e tjera (*ehua*, *ehuha*) përdoren për të shprehur të njëjtat ndjenja, por zakonisht me intensitet më të madh. P.sh.

— *Eu!* ti, xha Osman, ke llafe... (A. N. Mara, Brumi); E di unë, pastaj, se ku do të na nxjerrë ajo kartë! *Eu*, sa kam hequr unë nga të tilla marrëzira! (S. Spasse, Buzë, 240); — *Ehu*, ti kërkon shumë shpjegime! (P. Marko, Hasta, 356); — *Ehu!* Unë kam pirë rakë me opingë e s'më ka gjetur gjë. (F. Gjata, Tana, 38);

— *Ehua!* — më thoshte sa herë që më shikonte të mërzhitur. — Ç'u ve veshin thash e themeve të botës ti? (Sh. Musaraj, Isha unë, 27); Dhe sa ka të tillë që shesin qetë e arës, *ehuaaa!* (F. Gjata, Ujë, 31); *Ehuha*, sa kanë shkelur në këtë truall! (S. Pitarka, Familja, 10).

I (IH)

Kjo pasthirmë përbëhet nga një tingull i vetëm zonor, që shqiptohet i gjatë e në gjuhën e shkruar shprehet me përsëritjen e zanores *i*. Nganjëherë, sidomos në gjuhën e shkruar, shqiptohet e shkruhet me bashkëtingëllore fundore *h* (*ih*). Zakonisht shërben për të shprehur mospërfillje, përbuzje e sidomos krupë. Në ndonjë rast e kemi ndeshur edhe për frikë e habi. P.sh.

— Mirë e ka Emini! O do të hyjmë të gjithë në këtë brazdë, o s'ka tjetër udhë! — *I...i!* Pse, zotrote do na detyrosh? (T. Laço, Toka, 46); — *Iiii!* pse shkopinj janë këta! Shkopinj kam vetë, — dhe i ngriti të tija lart me mburje. (Fatosi, 2, 1973); — *Iiii*, sa të ndyrë janë! Thonë se hanë breshka! E zeza unë çfarë stomaku kanë që hanë breshka? (A. Kristo, Shkëndijat, 420); — Jo, mama, — thoshte — djathin nuk e ha, mishi nuk më pëlqen. *Iii* bukën me gjalpë s'e dua fare. (S. Jakova, Yllkat, 1, 1971). Do djathë? — *Ih!* s'e vë dot në gojë. Bie erë. (Gjergj Zheji, Pupagjeli, 13); Ama, u kacavjerr mirë dhe hipi në majë. Nija u tremb: — *Ii...* Zbrit Nush, se mos biesh! — tha ajo. (T. Laço, Nëntori, 12, 1971, 159); — *Iii*, ja bëri ajo me zë të hollë, *iii* mor im-zot, si arthkam unë në mes të burrave! (M. Kuteli, Kapllan Aga, 24).

OU (OHU, OHUA, OHUHA)

Përdorim më të tjerë, si në gjuhën e folur edhe në letërsinë artistike kanë format *ou* dhe *ohu*, të cilat shërbejnë për të shprehur jo vetëm mospërfillje e përbuzje, por edhe ndonjë ndjenjë tjetër, sidomos zemërim, pakënaqësi. Format e tjera (*ohua*, *ohuha*) përdoren për të shprehur të njëjtat ndjenja, por zakonisht me intensitet më të madh. p.sh.

— *Ou*, sa herë i kam dëgjuar këto! — ndërhyri i hakarritur Vat Ma-

rash Bregasi? (S. Spasse, Zjarre, 92); — *O-u*, Jorgo, përse mërzhitesh dhe ti. Këto janë gjëra të zakonshme. Lere të grijë sallatë. (Malet përcjellin oshëtimën, Tregime, 37, 1967, Tiranë); Liza — Mirë, dëgjo të të tregoj një gjë, por, po e kallëzove s'të kam shoqe. Hëna — *Ou!* Po t'u betova, pra. (A. Mamaqi, Për kujtim, 50); *Ohu*, unë kam njëzet vjet që e pi, — tha pa e prishur gjakun Nazmija. (E. Kadare, Një lindje, 169); — *Ohu*, moj mami, ç'më ngatëron tani? Unë do të shkoj me shoqet e klasës. (F. Topi, Fitorja e Mirës, 43); Ky zagar e kish origjinën nga Anglia... — *Ohua!* si u ngatërrua kjo punë! (M. Kallamata, Netë, 47); — *Ohuha!* Paske qef ti. Kërkon të bësh muhabet. (Hosteni, 2.7.1965, f. 8).

SHËNIM: Si për pasthirrmën *ou* ashtu edhe për pasthirrmën *au*, në letërsinë artistike, kemi ndeshur me të njëjtin përdorim, por fort rrallë, edhe format përkatëse *ouh* dhe *auh*, të cilat në thjeshtligjërime ndeshen pak më shpesh. P.sh.

— *Ouh*, ti Bardhyl e mat veten me hijen e mëngjezit. Pse me ç'e pandeh gjermanin ti? (S. Andoni, Pranvera, 94); *Auh*, kanë edhe ata cenet e tyre. (S. Andoni, Tregime, 90).

PTU

Këtë pasthirrmë e kemi ndeshur në forma të ndryshme (*ftu*, *pfy*, *ptu*, *tfu*, *tpu*). Më e përhapur në letërsinë artistike na rezulton forma *ptu*. Kjo pasthirrmë përdoret për të shprehur përbuzje, krupë, zemërim, P.sh.

Ftu! moj gojë ndyrë, moj turi lëtyrë. (A. Z. Çajupi, Baba-Tomorri, 105); Ai ka qenë birinxhi patriot, kurse ti... *ptu!* (B. Lëvonja, Ditari, 227); U bëkam pengesë unë që kam dyzet vjet në këtë minierë dhe më mirë njoh galeritë se odat e shtëpisë s'ime... *Pfy!* (N. Prifti, Çezma, 148); — *Pthu*, t'u shoftë, ke edhe mjekërr për komesar — tha Xhelali. (S. Godo, Zëra, 139); *Tfu!* të pështyj në surrat, perandor, Një palo burrë dy pëllëmbë, Një palo Viktor Me dy gisht këmbë! (D. Agolli, Mesditë, 8); — *Tpu*, të poshtërit. (A. Kristo, Shkëndijat, 23).

Y (HY)

Pasthirrma *y* ose *hy* (me *h* protetike, por me përdorim më të kufizuar) shërben për të shprehur jo vetëm mospërfillje e përbuzje, por edhe ndonjë ndjenjë a nuancë tjetër emocionale, sidomos krupë, urrejtje, zemërim, habi e mosbesim. Në disa raste shpreh njëkohësisht edhe një urdher (*ikë*, *hesht*, *mjafton*), ose shërben për të nënvizuar mendimin e shprehur nga fjalja pranë së cilës qëndron, por gjithmonë e shoqëruar edhe me ndonjë nuancë emocionale. p.sh.

— Pse s'më ke thënë? — Y, shpifaman! (A. Kristo, Shkëndijat, 543); — *Hy*, të preftë Perëndia ditët! *Hy*, të hëngërt një kolerë! Po baba je ti mor ditëzi? (N. Prifti, Një pushkë, 117); — Ta shoh pak — i foli vëllai, që nuk përmbahej kur shihte diçka që i bënte përshtypje. — *Hy*, tutje, se ti zbraza trutë! (S. Këllici, Kujtimet, 64); — Mos të hanë hundët ty, të vesh të mbështetësh kokën a? — *Hy!* Njerëz pa cipë! Turp të kini! (T. Laço, Toka, 47); Y, budalla! Fshiji lotët! O, ç'burrë! më dashke edhe nuse, pale! (S. Pitarka, Heronjtë, 11); *Yyyy*... Sa kohë kishte që Nija s'vinte të kolovitej ndajnat -herë kur dilte hëna! Sa kohë! (T. Laço, Nëntori, 12. 1971); — Në 30 kg peshë, 7 kg janë vetëm gjalp. — *Yyyy!* — u habitën vajzat dhe djemtë. (Pionieri, maj, 1973, f. 24).

5/ *Pasthirrmat që shprehin dhimbje a dëshpërim janë: ah, e, eh, mjer, of (hof), oi (oji), uf, vaj.*

AH

Pasthirrma *ah* ka përdorim shumë të gjerë e të larmishëm, si në gjuhën e folur ashtu edhe në gjuhën e shkruar. Mund të përdoret për të shprehur jo vetëm dhimbje e dëshpërim por edhe ndjenja të tjera si: zemërim, kërcënim, pakënaqësi, qortim, mërzi, habi, përbuzje, admirim, gëzim, kënaqësi etj. P.sh.

Ah more shokë sa e rëndë qënka vdekja! (N. Prifti, Tregime, 96); — Ah, e mjera unë, ma muarën më qafë vajzën, ma muarën më qafë. (E. Kadare, Një lindje, 165); Ah qen! Shtëpinë tënde po e djeg? Xhaxhanë tënd qëllon? thirrri nga odat e katit të dytë një zë i egër. (D. Agolli, Komisari, 242); Djali si i lodhun prej udhëtimit i tha me idhërim: — Ah, mëma ime e dashur, mos di një njeri që të ketë bilbil gjizarrë? (Folklor shqiptar, I, Proza, 394); — Ah, qen bir qeni! Do t'i them Tafës të të shtrojë në dru. (K. Jakova, Fshati, 280); Bujari — Ah, rrobaqepësit! Sa të ngushta i kanë prerë pantallonat! (L. Papa, Drama, 152); — Ah Demir, — tha Vjollca e mërziur nga tërë këto arësytetime. (E. Kadare, Një lindje, 216); — Ah, kështu?! Akoma s'e paske harruar tët motër?! u çudit ai dhe u fut nën divite. (A. Abdihoxha, Një vjeshtë, 39); Helena: (Me një pshe-rëtimë keqardhjeje). Ah, Teftë, e kam marrë jetën gjithnjë si një lojë fëmijësh. (Xh. Broja, Majlinda, 27); Ah! sa më pëlqen o kësollë kur të kujtoj, Se ti ndë shpirt gaz më mbolle dhe dot s't'harronj! (Asdren, Reze, 97); — Ah, ç'ja bëri! — thanë gratë. (D. Agolli, Komisari, 19); Kurrë s'do t'ju harroj! — Ah sa mirë. (P. Marko, Hasta, 98).

Kjo pasthirrmë përdoret shpesh edhe kur folësit i kujtohet papritur diçka, por gjithnjë e shoqëruar me ndjenjën përkatëse, në varësi nga konteksti e rrethanat e të folurit (sidomos keqardhje ose kënaqësi). P.sh.

— Po ti mbylle me kyç portën — tha Memua. — Ah, po! Mirë thua. (D. Agolli, Komisari, 94); Ah, po, thoshin se atje në kodrën e Durrësit, një kapter ulqinak kishte luftuar duke gjuajtur me top kryqëzorët italianë, që kishin qëndruar përpara Durrësit. (V. Kokona, Me valët, 23).

E

Pasthirrma *e*, e cila shpesh shqiptohet e zgjatur (në varësi nga konteksti), përdoret për të shprehur dhimbje e dëshpërim, por edhe ndonjë ndjenjë tjetër, sidomos keqardhje. P.sh.

Kur u përmendën gjithë këto, Gjoka psherëtiu thellë, hoqi cigaren nga buza, nxori shapkën e nxirë dhe sytë iu mbushën me lot. — E, mor vëlla! tha ai. — Më lëndohet zemra, kur i sjell ndër mend ato kohë. (Dh. Shuteriqi, Gurnecka, 33); Pse më shikon nëne? — Ee, jeto, më kujtohet edhe mua Llazua. (Z. Sako, Nga jeta, 24); Të rrëmben lufta Zeqine. Mbase edhe ty me Nafijen ndonjë ditë, për së shpejti. — E, e! Ne jemi të ngrira, moj shoqe, tha me keqardhje Zeqineja. (Dh. Shuteriqi, Çlirimtarët, II, 233).

Shpesh kjo fjalë përdoret për nxitje a si pjesëz pyetëse. Në ndonjë rast, kryesisht në thjeshtligjërim, përdoret edhe me kuptimin *mjaft*, *mjafton*. P.sh.

Unë ju ngërmova tim biri: «E, more ti, folë! Si të duken këto fjalë?»

(Dh. Shuteriqi, Tregime, 229); — *E*, more Baca Ndue, pse shqetësohesh kot. Kafshë njeriu është. (S. Spasse, Zjarre, 183); — *E?* pyeti ai përsëri me padurim. — Vajte? (E. Kadare, Një lindje, 226); — *E, e!* — ju kanos Batua. — Mos më llafos çapraz mua. (P. Isufi, Përrenjtë, 8).

Në thjeshtligjërime kjo fjalë përdoret gjithashtu shpesh si pjesëz pohimi. Në ndonjë rast, në varësi nga konteksti e intonacioni, përdoret jo aq për të pohuar se sa për të kundërshtuar a për të shprehur mosbesim, mospërfillje. P.sh.

Liza — Po viti vjetër? Rabia — Viti tjetër? Liza — *E*. (S. Pitarka, Heronjtë, 48); Ti fundja je burrë dhe sikur s'i ka lezet burrit të turpërohet si ndonjë grua e mbyllur. — *E, e*, ashtu është, por ja, sa të mësohem. Avash, avash. (K. Blushi, Fejesa, 116); — *E*, or, *e*, — tha Guri, — u zihet besë atyre! (A. Kristo, Shkëndijat, 590); — Qëndro, oj sqile — i tha kapoci — se ka ranë sherjati mërdheta. — *Ee*, tha sqilja, kur t'vejë haberi te kadiu që ka bo sherjatin, mua m'shkoi lkura te lkuraxhiu. (Folklor shqiptar, Proza, I, 71); Shemshedini (krenar) — As që më ka tërhequr ndonjëherë vemendjen. Pastaj atë e ka Pali në mbrojtje, njeriu më i moralshëm në ndërmarrje. Sania — *Eee!* I moralshëm! Vetëm kur nuk gjen. (K. Dusha, Zëri, 35).

EH

Sikurse pasthirrma *e* edhe pasthirrma *eh* shërben për të shprehur dhimbje e dëshpërim, por edhe ndonjë ndjenjë tjetër, sidomos keqardheje. P.sh.

— *Eh...*, moj nane, duen të na i internojnë, të na i çojnë në Itali! (S. Vaqarri, Guximtarët, Gjak nane, 11); *Eh*, të gJORËT! — tha Rrapua. (D. Agolli, Komisari, 272); — *Eh*, shkuan ato kohë, o bir, kur Shpiragaj vritej, po nuk ngitej me dorë... (J. Xoxa, Lumi, II, 253); — *Eh*, të ishte Kristofori. Sa qejf i ka këta pullumbat i gjori. (D. Agolli, Shkëlqimi, 52).

OF (HOF)


Pasthirrma *of* (ose *hof*, me *h* protetike dhe me përdorim të kufizuar) shërben për të shprehur dhimbje, dëshprim, e keqardheje por, sidomos në thjeshtligjërime, edhe mërzi, lodhje shpirtërore, herë-herë lehtësim. P.sh.

«*Ku-ku* zot, e *of* medet! Tek sarajet na kan djek». (Mbledhës, III, 75); *Of* i gjori unë, i varfri unë! Pse s'e dëgjova vëllanë? (M. Kuteli, Xinxifilua, 146); *Hof*, ç'na banë kta malsorët, qi i a nisën luftës pa ardhë koha e pa u përgatitë! (H. Stërmilli, Dashuri, 5); *Of*, harrova fare, dje i solla kësaj letër. (I. Spasse, Cuca, 140); *Of*, sa vapë që bënte! (V. Kokona, Me valët, 4).

OI (OJI)

Kjo pasthirrmë përdoret zakonisht për të shprehur dhimbje, dëshpërim, mjerim, pikëllim e keqardheje. Forma e zgjeruar *oji* (me bashkëtingëlloren epentetike *j*) ka përdorim të kufizuar, si në gjuhën e folur, ashtu edhe në letërsinë artistike. P.sh.

— *Oi, oi*, ku u katandisëm. Të na turpërojë aq ndyrë mavraziu Nelo. Turpi s'halet me bukë! (S. Spasse, Afërdita përsëri, 140); *Oji, oji!*



tashi edhe pakëzë, *oji, oji!* Do të ngarkonj e të shkonj! *oji, oji!* Babanë s'mund ta harronj! (Mbledhës, II, 67); *Oji*, si do ta gdhi gjithë këtë natë pa djalën... (V. Kokona, Me valët, 232); *Oji*, e zeza! Harrova zjarrin jashtë. (V. Kokona, Me valët, 86); — *Oiii*, moj Olimbi, sa më ka ardhur keq! Ku ke fuqi ti, moj e mjerë në këtë moshë, të durosh këto halle. (A. Kristo, Shkëndijat, 507);

Këtë pasthirmë, në disa raste, e kemi ndeshur edhe për të shprehur habi, frikë e sidomos pakënaqësi a zemërim. P.sh.

— *Oi, oi!* — ja bëri Ceni i habitur dhe kujtoi se atë vit s'kishte bërë asnjë barrë misër. (S. Spasse, Afërdita përsëri, 80); — *Oii-i-i* — klithi hanmi i vogël, duke u mbrapsur e llahtaritur. (A. Abdihoxa, Ëndra, 155); — *Oi*, dhe ti! Se s'është mjaft që më thanë mëndjemadhe ca të tjerë, na dhe ti tani! (P. Zoto, Verka, 42).

UF

Pasthirmra *uf* përdoret për të shprehur dhimbje, dëshpërim, pikëllim, mjerim etj. P.sh.

— *Uf*, si ma plase shpirtin — i thoshte e ama kur ky qante. (Migjeni, Novelza, 202); Mbarova, sharrova. *Uf* dhe i binte një herë kokës me grusht, një herë gjoksit, pastaj i kthehej dy herë kokës, dy herë gjoksit. (A. Abdihoxa, Një vjeshtë, 153); Por gjaku i hipi përsëri në kokë. Nga tërë anët u dëgjuan protesta, kësaj here me zë të lartë. — Ç'po bëhet këtu? — *Ufff*, ku katandisëm. (S. Spasse, Zjarre, 145); — *Uf*, unë e mjeria! Gjallë qenka gojëlidhura? (M. Kuteli, Xinxifilua, 22).

Këtë pasthirmë e ndeshim shpesh edhe në përdorime të tjera: për të shprehur frikë, zemërim, sidomos pakënaqësi e mërzi. P.sh.

«*Uf*, sa u tremba! Mezi po më mbajnë këmbët. Nuk rri më të gjua j zogj. (P. Elezi — L. Dodbiba, Gramatika e gjuhës shqipe, 66, 1960); — *Uf*, mor bir, na thatë gjakun me këto të shkreta demonstrata (A. Kristo, Shkëndijat, 593); Pse s'theu këmbën, po na erdhi përsëri!... *Uf*, dhe ky djalli s'pushon së qari!... (S. Spasse, Afërdita përsëri, 109); — *Uf*, dhe ti Çlirim, s'durohesh! Edhe s'e lave mirë fytyrën edhe më ngatërrrohesh nëpër këmbë! — i hoqi vërejtjen e ëma. (S. Spasse, Afërdita përsëri, 255); *Uf!* Sa e mërzitur kjo jetë! (Sh. Musaraj, Para, II, 540).

VAJ

Pasthirmra *vaj* shërben për të shprehur dhimbje, dëshpërim, mjerim, keqardhje. Shpesh shoqërohet me pasthirmën *medet*, me të cilën është sinonime. P.sh.

Por *vaj!* se' j dimën tjetër paske, o bylbyl i shkreti. Pa da zemra t'treti... (N. Mjeda, Vjersha, 34); Rreth pallatit të mbretit të turkut dëgjoheshin ditë për ditë vajtimet e turkeshave: *Vaj, vaj!* Pjetër Shini arbëri na i vrau burrat e djemtë! (M. Kuteli, Tregime, 255); Ku e lam'e ku na mbeti *Vaj*-vatani e mjer-mileti. (Fan S. Noli, Album, 69); *Vaj*-medet, çobankë. *vaj!* Qaj, çobank' e vogël, qaj... (N. Hakiu, Zëri, 4); Po sikur të përzihej me Gestapon, se i dinte edhe gjuhën, pa le të tjera! Atëhere, *vaj medet*. (A. Abdihoxa, Një vjeshtë, 118).

6/ Pasthirmra që shprehin kundërshtim, mosbesim janë: *a, aha, ba, (bah), ehe..*

A

Pasthirrmë me përdorim të gjerë e të larmishëm, si në gjuhën e folur ashtu dhe në gjuhën e shkruar. Përdoret shumë për të shprehur kundërshtim a qëndrim mohues (e shoqëruar gjithmonë, në varësi nga konteksti dhe intonacioni, me ndjenjën përkatëse, sidomos zemërim, pakënaqësi, kërcënim, përbuzje etj.), mosbesim, habi, mospërfillje, zemërim, pakënaqësi, dëshpërim, P.sh.

Unë u çova e i dhashë markën; kuptohet, edhe një bakshish. Por, për çudinë time, ai ma shtyu dorën fort sikur të ishte trembur nga diçka dhe më tha: — A! Të lutem! Të lutem! Ne nuk pranojmë që... nuk pranojmë! — dhe më tregoi tabelën: «Mos më ofendo!» (K. Blushi, Fejesa, 49); — A, plakë, e shkele!... Në këtë pikë s'jem me ty. (J. Xoxa, Juga, I, 431); Gjeta — Ata rrejnë. Hetuesi — A, jo, i pandehur. Ti vetë ke deponuar se i ke pasur shokë të besës, sidomos Nikën, me të cilin ke pirë gjak. (L. Papa, Drama, 75); — A! S'kuptoke! I ke këmbët thellë ti, si gjarpëri, dhe ashtu ta zvarrit fjalën... (T. Laço, Toka, 242); — A! Paski vendosur ju? Epo ahëre i thamë udhë e mbarë fukarallëkut! (T. Laço, Toka, 99); — A, domethënë të provojë nja tre a katër dhe pastaj të marrë kë t'i mbushet mendja. Jo, more, kush të ka mësuar kështu ty? (N. Prifti, Një pushkë, 98); «Më ra kur u ngrita». «A, pis ti a!» (P. Zoto, Verka, 161); — A, bre bir, sikur më re në qafë shumë tani në këtë hall që më ka rënë mi kokë. Besa, shumë. (S. Spasse, Buzë, 284); Vajti në odë të flij me burrët, hapi derën edhe ay i thotë nga jataku. — A moj grua, ç'më bëre, më more në qafë edhe mua edhe veten tënde bashkë. (Folklor shqiptar, Proza, III, 131);

Pasthirrma a përdoret shpesh kur kujtohem për diçka, natyrisht e shoqëruar edhe me ndonjë nuancë emocionale, në varësi nga konteksti dhe intonacioni. P.sh.

Mësuesi e hapi derën të dilte, por u kthye: — A, Memo, të fala nga Rustemi. (D. Agolli, Komisari, 118); — A... mirë, — thirri sikur iu kujtua diçka që po e kërkonte prej kohësh dhe u largua duke rrotulluar zinxhirin nëpër gishta. (B. Lëvonja, Ditari, 110).

SHËNIM: Kjo pasthirrmë duhet dalluar nga pjesëza pyetëse a, që përdoret në fillim a në fund të një fjalie pyetëse, por edhe e mëvetësishme. Veçanërisht kur përdoret në fund të një fjalie, me anën e së cilës kërkohet përgjigje, pjesëza a krahas kuptimit pyetës shoqërohet edhe me ndonjë nuanç të theksuar emocionale-shprehëse, sidomos përbuzje, zemërim, kërcënim. P.sh.

Po ne ç'jemi këtu? — A s'jemi edhe ne të bukura? (M. Kuteli, Xinxifilua, 166); A mos ke mbetur pa bukë? (F. Arapi, Patat, 35); I shite no i çikë shtrejt a? (Folklor shqiptar, Proza, III, 294); Pse? Më këmbë ke ardhur, A? (F. Gjata, Tana, 77); — A? ja bëri portieri që ju bë se ajo diçka pëshpëriti. — Fol më fort, se më kanë lënë veshët. (E. Kadare, Një lindje, 164).

AHA

Kjo pasthirrmë përdoret për të shprehur kundërshtim a qëndrim mohues (zakonisht të shoqëruar edhe me ndonjë nuancë emocionale) mosbesim e mospërfillje. P.sh.

— *Aha*, unë nuk dal kurrë në pension! (I. Spasse, Cuca, 143); — Kur surin eja e mere në çelë. — *Aha*, atë s'e ha unë. Ti gënjeve Zotin e s'po më gënjen mue! (K. Jakova, Fshati, 281); — *Aha*, kështu s'ke gjë në vijë, duhet të mbyllësh syrin e majtë, se përndryshe... (A. Abdihoxa, Një vjeshtë, 95); Marga — *Aha*, nuk qenka burrrë! (L. Papa, Drama, 85); Kur doli përtej filluan ta qëllonin, por *aha!* Iku lepurit. (M. Kallamata, Netë, 54).

SHËNIM: Kjo pasthirmë në thjeshtligjërime përdoret edhe për të shprehur pohim, si pjesëz pohuese, P.sh.

Aha — pohoi Alma. Kjo nuk donte të përmendte emrin e tij. (D. Agolli, Komisari, 143); *Aha*, e mora vesh! — foli si nëpër gjumë Qazimi duke e hedhur sërish pushkën në krahun tjetër. (A. Abdihoxa, Një vjeshtë, 35); — *Aha!* E mora vesh, — tha Xhoxhi duke ndryshuar zërin. — Po është udhë që s'del përtej ajo, o xha Llazi. (Sh. Musaraj, Isha unë, 96). Por në këtë funksion përdorim më të gjerë ka pjesëza *ëhë*. P.sh. — Të pëlqen? — *Ëhë*. (F. Arapi, Patat, 47).

BA (BAH)

Pasthirmë mjaft e përhapur, si në gjuhën e folur ashtu edhe në letërsinë artistike. Përdoret për të shprehur kundërshtim a qëndrim mohues, por e shoqëruar, në varësi nga konteksti dhe intonacioni, me ndjenjën përkatëse, sidomos zemërim, mosbesim, mospërfinllje, përbuzje. P.sh.

— *Bah* — tha ajo e zemëruar, — të kontrolloni shtëpinë tonë në mes të natës? (A. Kristo, Shkëndijat, 123); — Jo moj Lejla, çuni të piu për bukuri. — *Bah*, ja shikoj gjirin unë. E kam plumb. (E. Kadare, Një lindje, 169); — *Bah!* Ç'janë ato kërcënime! Ti po na kërcënon! (F. Gjata, Brezat, 192); Me Bimin do ta kesh edhe lidhjen. — Me Bimin? *Bah!* Si është e mundur? ... Jo, shoku Zef... (Sh. Musaraj, Para, II, 313).

Formën *ba* e gjejmë rrallë në letërsinë artistike. Kjo formë përdoret diçka më tepër në thjeshtligjërime, sidomos e përsëritur. P.sh. Ngrihet në mëngjes, kur i dolli pija, vështron rreth e rrotull... «*Ba*, ku jam kështu?!» Shikon rrobat, veshur si prift! «Po kjo? Kur u bëra prift unë?» (Folklor shqiptar, proza, 548); — *Ba-ba-ba!* Unë s'hyj më në qytet!... Eeni me ne, në çetë. Ç'thua ti Emin? (Dh. Shuteriqi, Çlirimtarët, II, 25).

Kjo pasthirmë mund të përdoret për të shprehur edhe thjesht ndjenjë habie. P.sh. — A e di që e ke qëlluar mu në mes? *Bah*, çfarë nishani! Hajde shihe... (A. Cerga, Bukuria, 118); «*Bah*, sa natë e prapë! Or po kështu si është bërë sot qyteti, nuk sheh hajër opinga. (A. Abdihoxa, Një vjeshtë, 154).

EHE

Pasthirrma *ehe* përdoret për të shprehur kundërshtim a qëndrim mohues, mosbesim dhe, në disa raste, thirrje a kushttrim. Nganjëherë përdoret për të nënvizuar mendimin a ndjenjën e shprehur nga fjalja që shoqëron. P.sh.

A do të thoshin kështu edhe për nënën e saj? *Ehe!* (P. Zoto, Verka, 148); — *Ehe*, zjarr te gurrëmëdhenjtë! (S. Spasse, Buzë, 363); Do të vini

të rrini nën hijen e këtyre mollëve e do të thoni: *Ehe!* Sa vjet kanë këto mollë. (F. Gjata, Tana, 81).

PASTHIRRMAT URDHËRORE

Pasthirrmat urdhërore shprehin dëshirën a vullnetin e folësit. Përdoren si mjet ndikimi e shtytjeje mbi qëniet e gjalla. Në këtë grup hyjnë pasthirrmat që shprehin lutje, dëshirë, urdhër, thirrje, nxitje etj. Mund të ndahen në tri nëngrupe: 1) pasthirrma që shprehin thirrje, 2) pasthirrma që shprehin urdhër, nxitje ose lutje dhe 3) pasthirrma që shprehin përshëndetje të ndryshme, mirënjohje, urime etj.

1) *Pasthirrma që shprehin thirrje janë: ej (hej), o, or, ore, ori, mor, more, mori, pst (pëst)*. Shërbejnë për thirrje, për të tërhequr vëmendjen e një a më shumë personave.

EJ ose HEJ

Janë pasthirrma sinonime, që përdoren shumë si në gjuhën e folur ashtu edhe në letërsinë artistike. *Hej* ka dalë nga *ej* me një *h* protetike. Përdoren zakonisht për thirrje dhe pa dallim gjinie. Në të tilla përdorime pasthirrma shpreh njëkohësisht edhe ndonjë ndjenjë, sidomos zemërim, kërcënim, përbuzje. P.sh.

Tellalli — *Ej*, milet! Sot po varet kapedani... (L. Papa, Drama, 92); — Gati? Gati? *Ej*, ju! Më vonë bisedohet! Tani zini vend aty dhe vini vesh. (P. Zoto, Verka, 53); Çobani vërsëllo për së dyti dhe thirri: — *Ej! Ej!*... — Ua bëri me dorë ushtarëve që afroheshin. (R. Nepravishta, Jehona, 21);

— *Heej*, gjysh! Ku e shpie? (F. Gjata, Tana, 71); — *Hej*, ti, më bjerë atë librin! (M. Kallamata, Netë, 81); *Hej*, Murat! — thirra unë. Ai nuk u përgjegj. (S. Godo, Zëra, 34).

Por në shumë raste thirrja zbehet e s'ndjehet fare, sepse mbizotëron ndjenja. Në këtë rast pasthirrma shërben për të shprehur thjesht ndjenja, sidomos frikë, dyshim, ironi, dëshpërim, dhimbje, habi, gëzim, kënaqësi. P.sh.

— *Ej*, ç'do të na merrni në qafë. (A. Kristo, Shkëndijat, 129); — Ahmet beu s'do t'ja dijë për çunat. — *E-e-ej!* Po komunizmit, ama, ja ka frikën! (A. Abdihoxa, Tri ngjyrat, 170); *Ej*, ç'më zuri me ju. (A. Abdihoxa, Një vjeshtë, 112); Se shumë gjamën ma ka ba, se fort zemrën m'a ka tha! *Hej-hej!* (V. Bala, Gjaku, 7); *Hej* si si qenka jeta. Sa të papritura paska. (R. Brahimi, Kthesa, 10); — *Hej*, sa bukur fole, moj shtojzovalle! — ja ktheu Muji. (M. Kuteli, Tregime, 121).

O, OR, ORE, ORI, MOR, MORE, MORI

Si fjalë që shërbejnë për të shprehur thirrje këto janë sinonime si me njëra tjetrën, ashtu edhe me pasthirrmat *ej* dhe *hej*. Por me pasthirrmat *ej*, *hej* dhe *o* u drejtojmë thirrje frymorëve pa dallim seksi, ndërsa me pasthirrmat *or*, *ore*, *ori*, *mor*, *more*, *mori* u drejtojmë thirrje ose personave të seksit mashkull, ose personave të seksit femër.⁴⁷

47) K. Kristoforidhi është i pari që vë në dukje se disa nga këto pasthirrma përdoren në varësi nga seksi «*Ore! more* (mashkullore); *moj, mori, ori* (femërore)» (Shih K. Kristoforidhi, vepër e cituar).

O

Kjo pasthirmë përdoret për t'iu drejtuar personave të çdo seksi, por edhe si përgjigje ndaj thirrjes që na drejtohet. P.sh.

— Kush je ti, o? — Unë Refati jam. (P. Zoto, Taksia, 122); — Kush je ti, ore? — Një gjahtar, o, një gjahtar! (J. Xoxa, Juga, 451); — Ngadale o, se na shurdhove! — tha Guri, i cili... (A. Kristo, Shkëndijat, 36); Thirri: — Oooo! Oooo! Oooo! — por iu përgjigj gremina e Sorkadhes nga poshtë me oshëtimën e saj. (S. Spasse, Buzë, 336); — O Remë! I thirri Xhemali. — Oo! — Zbrit, mor, zbrit, i tha plakui. (Çlirimtarët, I 129); Hë, leri llafet ti dhe mbaji iso, atë të bësh, — ju kanos një tjetër me shaka. — O Demo! — O, mor, o! (P. Jusufi, Përrenjtë, 75);

OR, ORE, MOR, MORE

Këto pasthirrma përdoren për t'iu drejtuar personave të seksit mashkull. P.sh.

— Or, po dil, ku do të dalësh, — thirrën ata. (H. Ceka, Horizonte, 27); Or gjer në këtë shkallë kanë arritur punërat? (F. Postoli, Lulja, 42); — Ore, zotërinj, u bënë dy orë që na mbani këtu. Jemi njerëz hallexhinj ne. (A. Abdihoxa, Tri ngjyrat, 405); Barinjtë qenë zgjuar dhe kishin dhënë alarmin: « Ujku, ore, ujku, në kope!» (J. Xoxa, Juga, 130); — Mor, shih mos na zë dhe pelat ashtu si atë harbinë e Pilos?... i foli Xox Longari tek priste t'i hipte kalit e të niseshin për në pishë. (J. Xoxa, Lumi, III, 273); — More, mos ka ndonjë rrezik kjo punë? (A. Kristo, Shkëndijat, 107); — Mirë se na erdhe, shoku Agronom! — More, ku të kam parë unë ty? — pyeti Perlati duke u përqaftuar. (F. Gjata, Brezat, 36).

ORI, MORI, MOJ

Këto pasthirrma përdoren për t'iu drejtuar personave të seksit femër. Nga këto përdorim më të gjerë ka pasthirrima *moj*, si në gjuhën e folur ashtu edhe në letërsinë artistike. P.sh.

— Pa hajde, ori! tha fshatari duke e parë me inat. (V. Koreshi, Toka, 30); Ganua trokiti nja dy herë me mashë pas gurit të vatrës dhe thirri: — Ori!... Ti... a do ta sjellësh sot apo mot atë rakinë? (T. Laço, Toka, 28); Mori Holle! Kush të hoqe? Mori, bac Musta (f) Ujka me ni shoqe. (Mbledhës, 47); — Mori!... Ti!... Aishe! — tha Semi, pasi ndjeu prapë shtrëngimin e fortë të dorës së Etlevës. (T. Laço, Toka, 187); — Moj, po çunat si janë! Spirua nga bëhet? (H. Ceka, Horizonte, 55); — Moj, po ç'ka qënë xha Kozmai më përpara? (J. Xoxa, Juga, 327).

Shpesh disa nga këto pasthirrma thirrrore, sidomos *moj*, *more* dhe *ore* shoqërohen me nuanca të theksuara emocionale (zemërim, kërcënim, habi etj.), madje, nganjëherë, thirrja zbehet e s'ndjehet fare, sepse mbi-zotëron ndjenja. P.sh.

Gruaja u zbe e u kullua në fytyrë. — Moj, ti... — i tha së bijës. Atë fotografi aty e ka vënë me dorën e vet yt atë. (F. Arapi, Patat, 29); — Moj, me ty po flas! (E. Kadare, Një lindje, 148); Një nga një! Po, a janë shumë ata të byrosë? — Nja dhjetë. — More! Pyesin, pyesin? (P. Zoto, Verka, 38); Kur shkonin njerëzit pranë saj abiteshin e thoshin:

— *More*, alamet qishe! I lumçin duart kush e ka borë! (Folklor shqiptar, Proza, IV, 467); — Si? Nasi Golemi? — Dora vetë. — *More!*... (R. Brahimi, Kthesa, 132); — *Moore!* Qenkam vrarë, jo shaka! (F. Gjata, Kënetë, 21); — *Ore*, sa i madh qenka? Sa një vaporr duket! (S. Xhai, Njeriu, 18).

Nga pasthirrmat *more*, *mori*, *ore*, *ori* kanë dalë (me heqje e alternime tingujsh) format *me*, *mi*, *mo*, *mër*, *mre*, *re*, *ri*, që përdoren në gjuhën e folur, por kanë përhapje të kufizuar, kryesisht dialektore, P.sh.

— O — thotë ki — cinë grua, *more*? — Gruan time, *mo*, që ke ti! (Folklor shqiptar, Proza, IV, 308); — Rri, Arap, se do t'pi një kafe njëherë. — Jo, *mre*, nuk të la. (Folklor shqiptar, Proza, III, 24); Po ky djalë është yll, *me!* tha një e tretë dhe më puthi faqen. (Dh. Shuteriqi, Gurnecka, 47); Vete qo yzmeqarja nalt ke zoja. — Kush â *mi*? — thotë. (Folklor shqiptar, Proza, IV, 165); Unë — tha — tu i bërtitë lene *mo*, se më theve vorbat; aty më hyni lezet, edhe ne mu tu i thanë *ri re*, *ri re*, se më *more* në qafë. (Folklor shqiptar, Proza, III, 377).

Fjalët *o*, *oj*, *or*, *ore*, *ori*, *moj*, *more*, *mori*, kur shoqërojnë thirrjet, shërbejnë si *pjesëza përforcuese thirrëse*. Në të tilla raste, këto fjalë nuk shërbejnë për thirrje, por për të përforcuar thirrjen e shprehur nga thirrori përkatës. Në këtë përdorim ato lidhen ngushtë nga pikëpamja e shqiptimit me thirrjet dhe nuk veçohen me ndonjë shenjë pikësimi. Mund të shoqërohen me emra frymorësh, në numër njëjës dhe në numër shumës, por disa, sidomos *o*, *oj*, *moj* mund të shoqërohen edhe me emra jo frymorësh.

Fjalët *mor*, *more*, *or*, *ore*, kur përdoren si pjesëza përforcuese, shoqërohen me emra të gjinisë mashkullore, P.sh.

Nuk ka talente rrethi ynë, *mor* vëlla dhe mbaroi. (Q. Buxheli, Kur qesh, 156); Rrini rehat, *mor* djema, se po na merrni në qafë. (K. Velça, Vëzhgime, 140); Plaku i vuri dorën në sup. — *More* Miti, po këtë të ma kishe thënë në krye fare e jo më flisje për punë. (N. Prifti, Një pushkë, 79); O ju miqt e mij e *more* shokë, s'bashku jetën ktu e kem kalue. (M. Gurakuqi, Gjeto, 50); — *Or* mik, kështu si ty dikur. ... Unë kam njohur shumë. (V. Skënderi, Vjershat, 27); Tundi dorën dhe na foli: — Gjah i mbarë, *or* shokë! — tha. (Gj. Zheji, Tregimet, 43); e nga e *more* këtë qelbësirë, *ore* Rushit? (M. Kallamata, Netë, 95).

Pjesëzat *moj*, *mori* (që nganjëherë shoqërohen edhe me pjesëzën *o*), *oj*, *ori*, përdoren me emra të gjinisë femërore. P.sh.

Frani: A u lodhe, *moj* Lule? (F. Kraja, Fisheku, 25); Ikni, *moj* gra, mos na lodhni. (F. Gjata, Në prapun, 108); Mos më lërë kurrë, *o moj* jetë e madhe. Mos m'i mbyll kurrë portat. (I. Kadare, Motive, 95); *O moj* mushka me dy zile, Që kullot ato trëndafile... (Mbledhës, 61); — Na, *mori* grua, pi e ti ca raki se m'i jep sisë djalit e dua të m'a bësh të fortë. (M. Kuteli, Kapllan, 24); Ti po largohesh, porse ditë e natë për ty un' do mendoj, *o mori* bi, veç ty do të kujtoj me dashuni! (Ll. Siliqi, Mrika, 25); — *Oj* shoqja Marë, shko deri në drejtori e më merr një bllok fletëdaljesh, se po jam tue ngarkue një kamion. (F. Ndoci, Diell, 401); *Ori* More, e zeza More, sa shumë trimat ti na i *more*. ... (Instituti i Shken-cave, Këngë, 172).

Pjesëza *o* përdoret me emra të gjinisë mashkullore e femërore. P.sh. Ishin zëra njerëzish që thërrisin: — O Perlat! ... O shoku Perlat!

(F. Gjata, Brezat, 142); O lumë, Në djepin tënd të butë flenë gjumë? (V. Skënderi, Vjersha, 25); Po ku më je, o thëllënxë e malit, o zëre e Çikës! — dhe e puthte Besën duke folur. (P. Marko, Stina, 431); E tani më thoni, o vëllezër, ç'ti jap? (F. Gjata, Përmbysja, 20).

Këto fjalë zakonisht vendosen para thirrorit, por disa mund të vendosen edhe pas tij. Kur janë të prapavendosura shqiptohen të veçuara, me përjashtim të pjesës *o*, e cila mund t'i prapangjitet një emri thirrur në numër njëjës dhe, në ndonjë rast, njëherazi edhe t'i paravihet, P.sh.

— Katundar... hallexhi. Vjen të lidhë plagën fëmijës, — tha Ristja i prekur — *Evgjeni moj!* — ju drejtua pastaj së shoqes — dil se të kërkojnë. (Sh. Musaraj, Para, I, 354); — Riza, Riza ore! — thirri. (A. Abdihoşa, Tri ngjyra, II, 41); «Ti, shoko, nisu për në fshat, lajmëro shtabin për vrojtimin dhe për shokun e vvarë...» (S. Andoni, Maleve, 105); O shoko, o partizan, na ndrit pak me atë pishë more se më duket se kam hyrë në një shinik. (F. Gjata, Përmbysja, 202);

Kur përdoren si pjesëza përforcuese këto fjalë mund të vendosen edhe para përemrit vetor të vetës së dytë, sidomos në numër njëjës. P.sh.

Skënderbeu e mori në krahë e i tha; o ti, moj lule e njomë, që ke çelur në mes të shkulmeve të lufrave, lule e kësaj zemrës sime të djegur! (M. Kuteli, Tregime, 250); O ju shqypëtarët e mi — u tha mbreti i madh i turqve Mehmeti, i biri i mbretit të madh Muratit. (M. Kuteli, Tregime, 236); Ai u suall nëpër skenë, hungëroi nja dy herë, seç tha ca fjalë pa kuptim, që s'u morën vesh në ishin sharje apo mallëkim dhe thirri: *oj ti...?* (R. Pulaha, Një vajzë, 140);

Si pjesëza përforcuese thirrëse mund të përdoren edhe format *me*, *mi*, *mo*, *mër*, *mre*, kur shoqërojnë thirrorët. Por edhe si pjesëza këto fjalë përdoren sidomos në gjuhën e folur, kanë përhapje të kufizuar, kryesisht dialektore. P.sh.

Hajde, *me* Lola, ç'pret? ja bënte Verka e i jepte shenjë me dorë. (P. Zoto, Verka, 147); Hej, ta prefsha lala syun, *mri* kumrije? (V. Kokona, Me valët, I, 24), — E, *mo* Dilo, ç'dërdëlis ashtu, mësimet thua? (A. Cerga, Bukuria, 116); — Mos, *mër* budalla, se të heq mbreti kokën, qysh të vjedhë ky? (Folklor shqiptar, Proza, IV, 181); Sa e madhe *mre* dajë Marku! Sa e madhe. (Dh. Shuteriqi, Gurnecka, 21).

PST ose PËST

Kjo pasthirmë përdoret për thirrje, sikurse pasthirmja *ej* dhe pa dallim gjinie, por zakonisht shqiptohet me zë të ulët me qëllim që tërheqim vëmendjen e atij apo të atyre të cilëve u drejtohem, pa rënë në sy të tjerëve. P.sh.

Punëtorja e dytë: *Pst!* (A. Mamaqi, Para fillimit, 30); Priste që druvari ta *vejë* re, por ky ishte kërrusur pas punës e bënte sikur nuk e shihte. — *Pëst! Pëst!* ja bëri ai që nga bishti i urës. (S. Andoni, Kandili, 116);

2) *Pasthirmja* që shprehin urdhër, nxitje ose lutje janë: *o burra* (o burrani); *eja* (ejani), *ele-ele* (hele-hele), *forca* (forcani), *haj* (hajt), *hap* (hopa), *hë* (hëni); *na* (nani), *sus*, *shët*, *tyt*, *të keqen*. Këto pasthirmja

zakonisht shërbejnë për të shprehur një urdhër, nxitje a lutje për fillimin e një veprimi të dhënë.

O BURRA (O BURRANI), FORCA (FORCANI), HOP (HOPA)

Përdoren jo vetëm si nxitje për të filluar shpejt dhe pa u kursyer një veprim, por edhe për të shpejtuar, për ta fuqizuar a për ta vazhduar deri në fund një veprim që ka nisur (p.sh. të vrapuarit, të shtyrët etj.). Pasthirrma *o burra (o burrani)* përdoret edhe si nxitje për të hedhur forcat në sulm, ndërsa pasthirrma *hop (hopa)* përdoret shpesh në kuptimin *ngrehu, kërce, hidhu*. Pasthirrma *o burra (o burrani)* përdoret nga meshkujt për meshkujt, ndërsa të tjerat përdoren pa dallim gjinie, p.sh.

— Përpara, shokë! Në sulm, vëllezër! *O burra*, përpara! Brigada, përpara! Për lirinë e popullit! — përsëritnin komandantët, komisarët. Këto thirrje përziheshin me tingujt rënqethës të borisë për sulm. (P. Marko, Stina, 454); — *O burra*, — bërtiti atëhere Markeni, — t'u qepemi pas doçëve! T'u zbatim brekët! (Gj. Zheji, Muret, 75); Fishekët e mitralozave t'armikut fërshëllenin në pyll rreth tyre... «*O burra, o burra!*» u jepte zemër partizani i plagosur dhe vazhdonin t'ecnin rrugë e pa rrugë. (S. Spasse, Afërdita përsëri, 7); — *O burrani* o shokë, se na e kaluan brigadat e tjera! (F. Gjata, Tana, 101);

— *Forca* rini — kumbon zëri i Besnikut. (Gaz. Pararoja, 25); *Forcani*, jepi! — thërrisnin dhe djersët u shkonin çurg. (D. Shaplo, Kohë, 26);

Duke i dhënë levës me sa mundte Nikua thërriste: — *O, hop...* Edhe një herë... *Hopa!* (R. Pulaha, Një vajzë, 14); Mirë, nën urë. *Hopa!* (Dh. Shuteriqi, Çlirimtarët, 7); *Hop...* Ti zëmë së gjalli! (A. Shehu, Vite, 8); — *Hopa*, në këmbë! Urdhëroi skuadërkomandantja. Të gjithë u ngrihtën, vajzat me të qeshura, nuset me të përdredhura, gratë me «oi». (J. Xoxa, Jugu, II, 122).

EJA (EJANI)

Kjo pasthirrmë, që përdoret edhe me mbaresën *-ni*, kur u drejtohem di a më shumë personave, është sinonime me pasthirrmën e huazuar hajde, por *eja* përdoret kryesisht në kuptimin e foljes *vij* në mënyrë urdhërore, prandaj në disa gramatika e fjalorë të shqipes është vlerësuar si formë suplotive e saj. Mund të përdoret e përsëritur, si edhe pasthirrma *hajde*. P.sh.

Ta shoqë ti moj nënë, sa i bukur është! S'e ka shokun. Ti po të duaç ta shikoç, *eja* nesër që në mëngjes, merr edhe një urë me zjarr me vete dhe *eja*. (Folklor shqiptar, Proza, IV, 536); — Lindita... Lindita! — Thirra që nga porta. — *Eja, eja!* — m'u përgjegj. (Fatosi, 2, 1973); *Ejani* me mua, — u tha duke i marrë për dore. (A. Abdihoxa, Një vjeshtë, 103).

Format *jakë* dhe *jani*, që vërehen në disa të folme të Shqipërisë juglindore, si dhe format *ja* dhe *eni* (nga *ejani*) në letërsinë artistike i gjejmë shumë rrallë. P.sh.

— Pa dashje, Cen, për Pejgamer. — *Ja* më hiq një plaçkë nga syu. (A. Abdihoxa, Tri ngjyra, 120); — Po kanë armë more Maço. *Jakë* ndër mënd. (A. Kristo, Shkëndijat, 143); *Eni, eni* më lart. (P. Marko, Hasta, 414).

ELE—ELE (HELE—HELE)

Pasthirrma *ele-ele*, ose me *h* protetike *hele-hele* përdoret si nxitje për të treguar diçka bashkëbiseduesi, për t'iu përgjigjur kërkesës që, si rregull, bëhet me anën e një fjalie pyetëse, pranë së cilës qëndron. Është e afërt me pasthirmën *hë*, por me përdorim më të kufizuar. Format *ele* ose *hele*, (jo të përsëritura) ndeshen më rrallë, si në gjuhën e folur, ashtu edhe në të shkruarën. P.sh. Mbas pak Prenga, Bruku dhe Doka hynë në zyrën e ministrit. — Po *ele*? — i pyeti Musaja. (K. Jakova, Fshati, 296); *Ele, ele*, ç'kemi asaj Peze, Leks? (Dh. Shuteriqi, Çlirimtarët, II, 204); *Hele*, o trim, ç'të fryn sot era? (V. Skënderi, Letër, 139); — *Hele—hele*, ç'kemi asaj Korçe, pa kemi kohë për këto muhabete? dhe plaku u mundua t'i jepte një drejtim tjetër kuvendimit. (S. Spasse, Afërdita përsëri, 26);

HAJ ose HAJT

Më e përhapur është forma *hajt*, por edhe kjo me përdorim të kufizuar. Përdoret për të shprehur urdhër a nxitje për fillimin e një veprimi. Zakonisht shoqërohet edhe me ndonjë nuancë emocionale, herë-herë të theksuar (sidomos përbuzje, mospërfillje, zemërim, kërcënim). P. sh.

Haj, shko tashi dhe sabotoje atë mbledhje. (J. Xoxa, Juga, II, 442); Mirë, në është puna me miq, ne këtu jemi. Pse të lodheni edhe tjetër herë? — *Haj*, bromb! — Brom të qoftë! (M. Kuteli, Fshati im, 10); *Hajt* vëllam, mos u tut se unë di ta loz mirë shpatën e nuk e le Pajin të na zërë rob. (M. Kuteli, Tregime, 88); *Hajt*, tregoni kush ju drejton? — thirrri si kafsha oficeri. (K. Jakova, Fshati, 317);

Në disa raste kjo pasthirmë përdoret në kuptimin *ikë* ose *eja*. P.sh. — *Hajt!* Mos më çaj kokën më! Nisu për krënd, dembel. (T. Laço, Toka, 98); *Haj* më mirë ti në qoshe. (M. Kuteli, Kapllan Aga, 24); Mer stomnat e *haj* për ujë, moj me lajka shumë. (Visaret, III, 78); Si e paske parë kështu kollozhëgu i paske thirrur derës: — *Haj* këtu, moj dreq! (M. Kuteli, Fshati, 21).

Për të përforcuar urdhërin a nxitjen kjo pasthirmë, sidomos forma *hajt* përdoret edhe e përsëritur. P.sh. Nëna — *Hajt, hajt*, pije edhe një për mua plakën. Mos ma prish qejfin. (S. Pitarka, Heronjtë, 51); *Hajt, hajt*, pse ju vjen zorr? Janë rregulla të organizatës këto. (P. Zoto, Verka, 46).

Hajt dhe *haj* e kanë prejardhjen nga pasthirrma e huazuar *hajde* (*hajde* — *hajt* — *hajt* — *haj*).

HË

Pasthirrma *hë* përdoret zakonisht për të shprehur urdhër a nxitje për fillimin e një veprimi, por zakonisht e shoqëruar me ndjenjën përkatëse, sidomos zemërim, kërcënim, përbuzje e mospërfillje. P.sh.

— *Hë* leri llafet ti dhe mbaji iso, atë të bësh, — ju kanos një tjetër me shaka. (P. Jusufi, Përrënjtë, 75); — *Hë*, se bëhet ky, bëhet. (F. Gjata, Tana, 53); — *Hë* pusho! — i qe kthyer Batua me të egër. (P. Jusufi, Përrënjtë, 80);

Mund të përdoret e përsëritur ose me mbaresën *-ni*, kur u drejtohem diçka a më shumë dëgjuesve, P. sh.

Hë, hë — më nxiste xhaxhua. Ai donte që unë të haja tri lugë dhe ai një. (S. Godo, *Zëra*, 43);... vidi-vidi pullumbeshë, është juaja hëna: *hëni!* (A. Asllani, *Vidi, vidi*, 9); Pesë pushkë dhe një bombë! Merrni arm' e municion, *hëni* shokë, të shkojmë, nga shtabi fjalë dërgojnë, armikun ta shpartallojmë. (Këngë popullore, I, 204).

Por, këtë pasthirrmë, nganjëherë të përsëritur, e gjejmë edhe në ndonjë përdorim tjetër, sidomos për të shprehur zemërim a kërcënim. P.sh. —Traktorist? *Hë!*... Po më dredhon si dhelpa nëpër ferrë... (J. Xoxa, *Juga*, II, 254); *Hë*, i mallkuari, akoma s'e ka harruar atë të merhumit... (Th. Kacorri, *Për mëmëdhenë*, 30); — *Hëhëhëhë* — e kërcënoi me gisht Batua, duke i rënë hiles. (P. Jusufi, *Përrenjtë*, 130).

Kjo pasthirrmë mund të përdoret edhe kur kujtohem për diçka. Në këtë rast shoqërohet edhe me ndonjë nuancë emocionale, sidomos për të shprehur një farë kënaqësie a gëzimi. P.sh. Që thua zotrote, ku e kishim fjalë? *Hë!* po. Te Bardhi. (N. Bulka, *Maska*, 117).

Pasthirrmën *hë* (*hëni*) e gjejmë të shoqëruar me pjesëzën zbutëse *pa*, ose me pasthirrmën *de*, në funksionin e një pjesëze përfunduese. P.sh.

Pa hë, moj bijë një herë edhe me ugr na qoftë, se kemi ditë që po e presim atë fjalë». (J. Xoxa, *Juga*, II, 419); — *Pa hë*, mor djalë, më thuaj syretin e parë të kuranit? (F. Gjata, *Përmbysja*, 6); Pse të mos ia thonte? *Hë de*, pse? (F. Gjata, *Tana*, 65); *Hë de*, përgjigju të kam rixha; pse nuk u shtua kapitali? (A. Abdihoqha, *Tri*, 73); — *Hëni de*, se na kënaqi ajo liria juaj, na shkriu fare., (H. Petrela, *Kronikë*, 185); «*Hëni de!* Akoma ju aty s'mbaruat?» (Sh. Musarai, *Para*, II, 107).

Nga përdorimi i kësaj pasthirrme me fjalën *de* ka dalë forma *hënde*, ndërsa nga *hënde+de* ka dalë forma *hëndede*. Këto kanë ende përdorim të kufizuar, sidomos në letërsinë artistike. Përdoren me kuptim nxitës. P. sh.

— Po *hënde*, se s'kam as unë ç'të shkruaj, po s'folët ju! (J. Xoxa, *Juga*, II, 446); *Hënde de*, na e trego, se për meselera jemi mbledhur... (M. Kallamata, *Netë*, 5); — Po *hëndede*, moj korbë, ç'më shikon ashtu, si berri kasapin. (J. Xoxa, *Juga*, I, 34).

SHËNIM:

Pasthirrmën *hë*, të përsëritur, e kemi gjetur në ndonjë rast si pjesëz të përafërisë dhe si ndajfolje. P.sh.

Kaluen ma të poshtmen jetë e ishin *hë-hë* tuj kalue edhe të ndërmjemen jetë, kur u mbarue ushqimi. (Folklor shqiptar, Proza, 182); *Hë, hë*, shkuan ca muaj, kur edhe beu na bën një çetë. Çetë e ballit, siç i thoshin. (M. Zaloshnja, *Rreth zjarrit*, 101).

NA (*NANI*, me mbaresën — *ni*, por që ndeshet kryesisht në të folur) Pasthirrma *na* (me a të shkurtër) përdoret për urdhër a nxitje, në kuptimin «merre» «*hë*», ose për thirrje në kuptimin e pasthirrmës *ej*, ore etj. P. sh.

Por hoxha as që donte t'ja dinte nga ajo anë. Dhe ai i gropës, pasi u mendua pakëz, tha: — Na dorën, hoxhë efendi, *na!* Me të dëgjuar «*na*» hoxha, zgjati dorën e vet dhe e nxorri nga grupa fatkeqin. (Folklor shqiptar, Proza popullore, Anekdota, V, 259); Shoku Q. ja zgjati raportin shoku Žylo. — *Na*, lexoje, Shto ndonjë gjë që të duket e arësyeshme dhe pregatitu të flasësh. (D. Agolli, *Shkëlqimi*, 9); — *Na Gaspër!* — ja ban

zotnija shëgertit të tij. — Shko në famulli e thuej të ma thonë një meshe për shpirt të parëve, (Folk. shqipt., anekdota, V. 249); — Na moj cucë! E Ramizit je ti? (F. Gjata, Brezat, f. 27);

Këtë pasthirrme e gjejmë edhe për të ndjellur kafshët shtëpiake. Në këtë rast folësi shpesh zgjat krahun e i jep ose bën sikur i jep diçka për të ngrënë kafshës. P. sh.

Një zë i hollë fëmije, në shpatin përkundrejt, ndillte me ngulm një gen: — «Na, balo, na, naa...!» dhe zëri i tij përhapej anembanë... (N. Prifti, Çezma, f. 36);

Në mjaft raste pasthirrma *na* përdoret në kuptimin e pjesëzës dëftuese *ja*, por e shoqëruar zakonisht edhe me ndonjë nuancë të theksuar emocionale si zemërim, përbuzje, mospërfillje, kënaqësi, ironi etj. Në këto përdorime zanorja *a* e pasthirmës shqiptohet zakonisht e zgjatur. P.sh. Të premtan. E asgjë. Fundi, *na-a*, — dhe zoti Kristaq ngriti bërnylin. (A. Abdihoxa, Tri ngjyrat, I, 1965, f. 116); Gjithë ditën e ditës, im atë çiftën në krah dhe, *na!* e bënte pyllin! (M. Kallamata, Netë, f. 50); Edhe Selimi ama; *naa*, kock' e lëkurë qënka bërë! (S. Spasse, Ata nuk ishin, 161); — Oj tezja ime, pa eja të shohësh krushkamadhin, *naaa* i ka mustaqet! (S. Spasse, Zjarre, f. 229); Jo vetëm që harxhove aq para kur e bleve, por ajo e ka lyfytin *na-a* — Mal agaj hapi duart sa mundi — s'ka të ngopur me benzinë. (A. Abdihoxa, Tri ngjyrat, I, 103). Në gjuhën e folur, këto pasthirrma, në raste si të mësipërmet, shoqërohen zakonisht me gjepte për të treguar përmasat e sendit përkatës si dhe për të nënvizuar anën emocionale të të folurit e për të rritur fuqinë shprehëse të tij. Kështu, p.sh., në shembujt e parë tregohet përkatësisht bërnyli (herë-herë edhe duke e goditur me dorë) ose mund të tregohet pëllëmba e dorës (herë-herë duke i fryrë), në shembullin e tretë zakonisht mbledhet dora grusht duke ngritur gishtin tregues, ndërsa në shembujt e tjerë tregohen zakonisht me duar përmasat e sendeve përkatëse. Duke treguar bërnylin ose pëllëmbën e dorës folësi ka parasysh që nga sendi i dhënë s'ka mbetur gjë, ndërsa në shembujt e tjerë përmasat e sendit paraqiten më të vogla ose më të mëdha nga ç'janë në të vërtetë.

Pasthirrma *na* përdoret shpesh edhe kur i japim tjetrit munxat (paçet). Në këtë rast shoqërohet me ndjenjat përkatëse, sidomos përbuzje, mospërfillje, mosbesim, zemërim, urrejtje.

Në gjuhën e folur, e shoqëruar gjithmonë edhe me ndjenjën përkatëse (sidomos përbuzje e zemërim), përdoret edhe me kuptim mohues, për të shprehur mosbesim ose kundërshtim ndaj kryerjes së një veprimi. Edhe në këto raste zanorja *a* shqiptohet zakonisht e gjatë e shoqërohet me gjepte si tregimi i bërnylit, mbledhja e dorës grusht duke ngritur gishtin e madh lart, ose goditja me dorë e kycit të saj. P.sh. — Do ta marr. — Na, hyp këtu të shohësh Stambollin. (A. Abdihoxa, Tri ngjyrat, II, 173).

SUS dhe SHËT

Pasthirrat *sus* dhe *shët* (e para shqiptohet me zanoren *u* të shkurtër dhe e dyta me zanoren *ë* të zgjatur) përdoren si urdhër për vendosjen e qetësisë a për të heshtur, por shoqërohen edhe me ndjenjat përkatëse, zakonisht frikë (*shët*) dhe zemërim, kërcënim, përbuzje e mospërfillje (*sus*). Pasthirrma *sus* përdoret edhe për kafshët, kur duam që ato

të rrinë qirithi. Pasthirma sus shqiptohet zakonisht me zë të lartë, ndërsa *shët* me zë të ulët. Krahës formës *shët*, që është më e përhapur, përdoren edhe format me tinguj bashkëtingëllorë, pa zanoren *ë* (*sht*, *st* etj.). Që të dyja këto pasthirrma shoqërohen shpesh me gjeste (duke afruar gishtin tregues tek buzët). P. sh.

— *Sus*, more! Djemtë do pyes unë! (T. Laço, Toka, 70); — Bravo, xha Tirkë, bravo! iu dha të thotë me rromuz Miti Lafazani. *Sus*, ti atje, s'ë kam me ty! — ja preu shkurt plaku. (S. Spasse, Buzë, 61); *Sus!* Borgjezë bastardë nga urrejtja e frika budallallepsur. *Sus*. (F. Arapi, Poema);

— *Shët* — shushuriti gruaja e trembur dhe me majat e gishtave si mace hapi derën dhe pa në çardhak. (T. Laço, Toka, 261); Ata që ishin para tyre, kthyen kokën pas dhe u pëshpëritën «*shëëët!*» (P. Marko, Stina, 353); Pa u menduar shumë ju afrova dhe ai me dorën në buzë, më bënte: — *Shshttt!* (S. Xhai, Kur ndërtohej, 41).

TYT

Pasthirrma *tyt* shërben për t'i drejtuar bashkëbiseduesit urdhër për t'u larguar ose për të heshtur. Ka përdorim të kufizuar sidomos në lehtërsinë artistike. Kuptimi i saj, në varësi nga konteksti e situata, gërshe-tohet zakonisht edhe me ndonjë ndjenjë të folësit, sidomos zëmërim, përbuzje, kërcënim, mosbesim. Nganjëherë përdoret për t'i tërhequr vemendjen dikujt, me qëllim që të tregojë kujdes. P.sh. *Tyt!* Hajt shporru nga ke ardhur, se t'i theva brinjët! (F. Gjata, Tana, 46); — *Tyt...*, i paudhë! — ju kërcënua Brahua. — Ma paske atë gjuhë për të prerë. (T. Laço, Toka, 165); Fieta me një dialë. Ballëtë s'ia dhashë, *Tyt*, o derr i thashë. (Mbledhës të hershëm, 291); — Është pushkë Rusie, Danë. — *Tyt*, Dine! Po si erdhi kjo deri këtu? (A. Abdihoxxha, Një vjeshtë, 90); Një si perde e hollë ia veshi sytë dhe në çast këmbët iu penguan nëpër gropat e kalldrëmit. — *Tyt*, Demir efendi, mbahu bre burrë! E zuri për krahu usta Dineja. — Thuaj ç'të duash, u plakëm. (A. Abdihoxxha, Një vjeshtë, 169).

TË KEQEN

Kjo pasthirrmë përdoret për lutje ose për përgjërime. Është sinonime me pasthirrmën e huazuar *aman*. P. sh.

— Pak ujë, motër, *të keqen!* (E. Kadare, Një lindje, 3); — Bir, *të keqen*, bir, qënke kimetli... (N. Hakiu, Zëri i fyellit, 27); — Shiko, *të keqen*, gëk këtë punë! Këtu e thamë këtu e lamë. (M. Xhaxhiu, Lirika 28).



Një vend të veçantë ndërmjet pasthirrmave që shprehin urdhër a nxitje zënë pasthirrmat me anën e të cilave ndjellim a ndërsejmë kafshët, i frikësojmë ose i nxisim për fillimin, ndërprerjen, vazhdimin ose përfundimin e një veprimi. P.sh.

— *Or, oorrr!* — e ndillte bagëtinë herë pas here dhe me kërrabën u binte degëve të shkozave. (S. Spasse, Afërdita përsëri, 3); — *Prrrrrruuu!* Ia bëri përsëri Hamiti duke tërhequr frerin dhe kali ndaloj vrapin. (F. Gjata, Në pragu, 192); — *Uaha*, kazil, *uaha*, kuqo! u foli Piloja qeve që të ndalojnë dhe vetë, si pështeti hostenin në tokë, u hodh poshtë. (J. Xoxa, Lumi, I, 19).

Disa prej këtyre pasthirmave, kryesisht ato me të cilat u drejtoheni kafshëve shtëpiake — *cap-cap, giç-giç, kuç-kuç, mac-mac, pat-pat, pul-pul*, (që shqiptohen me zanore të shkurtër dhe janë formuar nga përsëritja e formave të emrave përkatës, zakonisht nga tema e cinguar e tyre: *cap, ogiç, kuç, mace, patë, pulë*), *çit, pis, yja, tik-tik, ush* — e kanë pak a shumë të përcaktuar përbërjen fonetike, sidomos sferën e përdorimit. Kështu, pasthirrat *cap-cap, giç-giç, kuç-kuç, mac-mac, pat-pat, pul-pul* përdoren për të ndjellur kafshët që emërtojnë emrat nga të cilët përkatësisht janë formuar. Nga këto, fjala *kuç*, kur nuk përsëritet, përdoret për ta frikësuar a larguar kafshën. P. sh.

.... Unë do të flas, do të ndjell: «Na *kuç-kuç!*» (Folklor shqiptar, Proza, 599); Plaka — *Kuç*, mor dreq i zgjeburë, ç'më je tharë e treturë! (V. Kokona, Lulja, 9); E dëgjoi njerka nga jataku, që flijnë akoma, edhe i foli qëniti e i tha: — *Kuç* të hangërt tërbora, se Maro Përhiturën tani e kanë mbitur xhinërit, edhe ti thua që Maro Përhitura e flirinjtë. (Folklor, Proza, 306).

Pasthirrat e tjera kanë këto përdorime:

ÇIT

Përdoret për të frikësuar dhe larguar macen. P. sh. *Çit* moi mace, moi e shikretë! Ja bëra burrit për drekë. (Mbledhës, II, 38); Ndejti e ndejti ai pirashi, po më në fund s'ju durua e i hoqi një bacë maces: — *Çit*, moj lanete, se më duke si paguri i rakisë. (Folklor, Proza, anekdota, V, 554). Shqiptohet me i të shkurtër.

PIS

Shqiptohet me zanore të zgjatur dhe zakonisht përdoret shpesh e përsëritur. Përdoret për të ndjellur macen. P.sh. — *Piiis!* e ndillte babai. — *Piiis!* — e ndillnin edhe mëma me Blertën. Po macja e vogël ishte lart n'akasje. (Z. Sako, Lulja, 6); Mace e vogël, *pis, pis, pis*, pa më, thuaj ç'po zvarris? (S. Çomora, Sgalemi, 3);

ISH

Përdoret për të larguar pulat në veçanti, zogjtë e shpezëve shtëpiake si dhe shpezët shtëpiake në përgjithësi (kur janë bashkë). P. sh. «*Ish*» deshi t'i përzejë ai, po pulat s'lëvizën nga vendi. (A. Abdihojha, Tri ngjyrat, II, 29);

TIK-TIK

Përdoret për të afruar pulat në veçanti, zogjtë e shpezëve shtëpiake si dhe shpezët shtëpiake në përgjithësi (kur janë bashkë). P.sh. Unë vete te ajo ditë për ditë, i thërres pulat e saj «*tik-tik-tik*» dhe u hedh për të ngrënë. (B. Dedja, Një udhëtim, 13). Përdoret vetëm me gjymtyrë të përsëritur.

ÝJA

Përdoret për të ndërsyer kalin a mushkën, me qëllim që të shtojnë shpejtësinë. Shpesh kjo pasthirmë shoqërohet me fjalët *or derr, or dreq, or plaç* etj. ose me emrin e kafshës. P.sh. Kur duallnë në xhade të gjithë

hipën në qerre. Ahere, Hamiti, duke mbajtur në duar frenat e kalit tha: — U bë tamam si karroca e Çapajevit! *Yja!* — ja bëri ai kalit. (F. Gjata, Në pragun, 192).

USH

Përdoret për të nxitur gomarin që të ecë (me *u* të shkurtër), ndërsa *ush* (me *u* të gjatë) përdoret për ta ndaluar atë. P.sh. — *Ush*, ngordhç! (F. Gjata, Përmbysja, 204).

3) *Pasthirrma që shprehin përshëndetje të ndryshme, mirënjohje, urime, etj.: faleminderit, lamtumirë, mirëmëngjes, mirëdita, mirëmbërëma, mirë se erdhe, mirë se vjen, mirë mbeç, tungjatjeta, udha e mbarë etj.* P.sh. — Jo, *faleminderit*. Me punë shkoj mirë tashti. (Sh. Musaraj, Para, I, 529); Ai mori borselinën, e vuri në kokë, hapi derën dhe tha: — *Lamtumirë!* (D. Agolli, Komisari, 158); — *Mirë u pafshim*, gjyshi i Meremes (Gj. Zheji, Tregimet, 75); ... u lëvdua se i thoshin «*mirëmëngjes, nëno*» e «*mirëmbërëma, nëno*» dhe u qeshte buza si njerëz me shkollë që ishin. (V. Sejko, Orë të vështira, 4-5); — *Mirëmëngjesni*, moj bija! Ç'bëni, si jini, u ngritët a flini? (M. Kuteli, Xinxifilua, 170); — *Mirëdita*, u përgjegj Besniku. Ai e kishte parë këtë njeri në darkën e Kremlinit, pranë tryezës kryesore. (I. Kadare, Dimri, 126); Më në fund hynë. Ishin Neta me Nadiren. Të gëzuara si gjithmonë, me flokët pak të lagura. — *Mirëmbërëma*. — *Mirëmbërëmani*, shoqe. (I. Kadare, Dimri, 84); «*Mirë se erdhe*», tha Rahmani, u ngrit e shkoi i dha dorën. (Dh. Shuteriqi, Tregime, 214); Këtyre u bëri me dorë e u tha: — *Mirë se erdhët*. (Dh. Shuteriqi, Tregime, 130); *Mirë se vjen*, me krahë të letë, Dallëndryshë, tui fluturue! (F. Shiroka, Zani i zemrës, Tiranë, 1933); *Udha e mbarë*, se erdh prandvera; Shko Dallndryshë tue fluturue... (F. Shiroka, Zani, 13); Mbarë paç, o zot i madh — ju përgjegj mbreti. (Folklor, Proza, I, 153).

Këto fjalë e shprehje pasthirrmore zakonisht ende nuk e kanë humbur, ose nuk e kanë dobësuar plotësisht kuptimin leksikor, por shqiptohen me ngjyrë të fortë emocionale, përdoren thjesht si përshëndetje dhe afrohen me grupin e pasthirrmave që shprehin urdhër a nxitje. Kjo vihet re qartë sidomos në fjalën *tungjatjeta*, e cila, pavarësisht nga kuptimi i fjalëve që e përbëjnë, përdoret thjesht si përshëndetje gjatë një takimi a ndarjeje, shërbim të cilin mund ta kryejë fare mirë ndonjë përshëndetje tjetër, që ka në përbërjen e saj fjalë e forma të tjera fjalësh, p.sh., *mirëdita, mirëmëngjes, ditën e mirë* etj.

Disa nga pasthirrmat e këtij grupi janë formuar nga përngjitja e fjalëve përkatëse, të plota a të cinguar, për shkak të përdorimit të gjatë e të vazhdueshëm të këtyre fjalive si formula stereotipe urimi. Të tilla janë fjalët *faleminderit, lamtumirë, mirupafshim, tungjatjeta*, të cilat kanë kuptim tërësor dhe vlerën e një fjalie të pazbërthyeshme e të paanalizueshme në gjymtyrë të veçanta; Në këto bashkime fjalësh pjesët përbërëse i kanë humbur plotësisht funksionet gramatikore që kanë pasur dhe në ndonjë rast kanë pësuar edhe ndryshime fonetike.

Përngjitje kemi edhe në pasthirrmat *mirëmëngjes, mirëdita, mirëmbërëma*, që janë formuar nga fjala *mirë*, si gjymtyrë e parë, me një emër. Nga pikëpamja e theksimit shihet mjaft qartë se pjesët përbërëse edhe në këto pasthirrma nuk ruajnë secila theksin e veçantë, përkundrazi theksi kryesor bie mbi gjymtyrën e fundit, gjë që është një nga tiparet

dalluese të çdo kompozite të shqipes. Në gjuhën e folur popullore këto pasthirrma shoqërohen edhe me morfemën *-ni*, kur u drejtohem dy a më shumë njerëzve (*mirëmëngjezni*, *mirëditani*, *mirëmbërmani*). Kjo tregon se për folësin këto ndjehen si një fjalë e vetme. Është për t'u vënë në dukje se në këto bashkime fjalësh pjesët përbërëse janë cinguar nga pikëpamja e formës. Kështu, p.sh., gjymtyra e parë, në të gjitha rastet, sido që është një mbiemër i nyjshëm, na paraqitet pa nyjë, ndërsa emri në pasthirrmën *mirëmbërma* na paraqitet në formën *mbrërma* dhe jo *mbrëmja*.

Në përshëndetjet e tjera si *mirë ardhsh*, *mirë mbeç*, *mirë se erdhe*, *mirë se vjen*, *udha e mbarë*, *udhë të mbarë*, *mbarë paç* etj. nuk kemi përngjitje, prandaj edhe në letërsinë artistike, me të drejtë, pjesët përbërëse i gjejmë zakonisht të shkruara ndaras. Ky qëndrim përligjet, krahas të tjerave, me faktin që në këto shprehje pasthirrmore përbërja nuk është e qëndrueshme, fjalët paraqiten në disa forma dhe ç'është më e rëndësishme për karakterin e një strukture — komponentët ruajnë theksin e veçantë. Krahaso: *mirë se erdhe*, *mirë se erdhët*, *mirë se na erdhe*, *mirë se na erdhët*, *mirë se na ke ardhur*, *mirë se na keni ardhur*, *mirë se vjen*, *mirë se vini*, *mirë se të vish*, *mirë se të vini*, *mirë ardhsh*, *mirë ardhshi* etj.

Në këtë grup pasthirrmash hyjnë edhe disa përshëndetje që paraqiten në formë shprehjeje e me kuptim tërësor: *natën e mirë*, *ditën e mirë*. Këto konstrakte kanë humbur lidhjet e tyre me fjalitë përkatëse të plota dhe, sido që nuk e kanë humbur ose nuk e kanë dobësuar plotësisht kuptimin leksikor, shqiptohen me ngjyrë të fortë emocionale e përdoren thjesht si përshëndetje, prandaj afrohen me grupin e pasthirrmave që shprehin urdhër e nxitje. P.sh.

Faleminderit; gëzuar dhe juve, për shumë vjet... *Natën e mirë*. (S. Pitarka, Heronjtë, 60); — *Ditën e mirë*, — tha Mira dhe mori çantën. (I. Kadare, Dimri, 59).

VENDI DHE FUNKSIONI I PASTHIRRMAVE

Pasthirrmat vendosen në fillim të fjalisë, por shpesh vendosen edhe në mes ose në fund të saj.

Kur përdoren në fillim ose në fund të fjalisë, ato zakonisht veçohen nga fjalët e tjera të fjalisë me presë. P.sh.

A, Qano, unë s'i kam qejf hilet! (D. Agolli, Komisari, 12); — Ah, si janë ato — tha Sadedini dhe i ra ballit. — Pyetmë mua që kam parë. (I. Kadare, Kështjella, 41); Olimbia — Po edhe nazet e doktorit, nuk durohen, *ama!* (S. Çomora, Karnavalet, 139); — Ç'na thënke, more?! (N. Prifti, Tregime, 73).

Kur përdoren në mes të fjalisë, pasthirrmat vendosen ndërmjet dy presave. P.sh.

E bukur është nusja, s'ka të sharë, po edhe dhëndëri, *ama*, s'bie poshtë! (V. Kokona, Me valët, II, 95); midis ty dhe mua, *haj*, gjysmë e botës paska hyr'. (A. Asllani, Ku merr zjarr, 114); Pret fëmij e përgjyruar,

Pret babanë e përmalluar. Ta shikojnë pakëz pranë, Se me të, *oh*, gjallë u ndanë! (A. Kristo, E humbi toruan, 12).

Pasthirrmat mund të përdoren edhe të mëvetësishme. Në të tilla raste vihet pas tyre pikëçuditëse dhe shqiptohen me fuqi të veçantë. P.sh.

— *Ah!* Ti më qënke! Ku të kam parë unë ty? (F. Gjata, Tana, 46);

— *Alo!* Kush jeni ju lutem?... (Q. Buxheli, Kur qesh, 160); Afroviti

— *U!* Na dashka të martohet profesori i gjimnastikës. Marto përpara kushurirën tënde! (S. Çomora, Karnavalet, 143); *Ua!* Po me se do të hypësh? Ku gjendet dot një shkallë kaq e gjatë? (Nella Sinaeri, Kokrra, 7); Komandanti Rrapo mendoj: «Ç'rrefjan qenka ky, more, ç'rrefjan! *Pupu!*» (D. Agolli, Komisari, 209); — Arrestuan katër komunistë, — foli në vend të Tajarit burri i ngjallur dhe shtoi: — *Ehu!* (A. Abdihoxxha, Tri ngjyrat, I, 120); E sheh ti? *Bravo!* (D. Agolli, Komisari, 230); Nuk ish e mundur të mungonte. *Djall o punë!* (A.N. Mara, Brumi, 148).

Kur pasthirrmat përdoren të mëvetësishme, përveç pikëçuditëses mund të vihet njëherazi edhe pikëpyetje. Kjo ndodh, sa herë që ndjenja, (sidomos habia) e shprehur nga pasthirrma, shoqërohet edhe me nuancë pyetëse. P.sh.

Kij kujdes, mos folë shumë... Afroviti — *Ua!*? (S. Çomora, Karnavalet, 143); — Ju na keni lënë pa bukë, — tha Besniku me zë të shurdhër. — *A!*? ia bëri i habitur tjetri. — Pa bukë? (I. Kadare, Dimri, 114);

...

Pasthirrmat mund të përdoren me vlerën e një fjalie të tërë të paravarur, ose me vlerën e një fjale të vetmuar sintaktikisht në përbërjen e fjalisë.

Me vlerën e një fjalie pasthirrmat përdoren gjerësisht për ndërtimin e fjalive thirrmore. P.sh.

— — Shqetësuar? *Bah!* Ç'është ajo fjalë? (Sh. Musaraj, Para, I, 160); — *Ej!* Mos e hidh! — i thirri Pucelli, i cili u ngrit dhe e mori. (P. Marko, Hasta, 295); — *Uaaa!* Pse, prej meje u dogjën? (A. Cerga, Bukuria, 157); — *Piis!* e ndillte babai. (Z. Sako, Lulja, 6).

Krahasimi i fjalive thirrmore (të ndërtuara me pasthirrma) me fjali që janë të afërta nga kuptimi me to, tregon se të parat janë të pazbërthyeshme e të paanalizueshme në gjymtyrë të veçanta dhe shprehin ndjenja e dëshira në formën më të përgjithshme, ndërsa të dytat janë të zbërthyeshme e të analizueshme në gjymtyrë të veçanta dhe shprehin mendime ku tregohet personi a veta që vepron, veprimet, objektet dhe rrethanat e tjera të ndryshme. P.sh.

Burri — More Loni! Loni — *Hë?*! Gruaja — Ç'të ka gjetur, more Loni?! (K. Blushi, Drama, 106). Këtu *hë* shpreh urdhër a nxitje dhe është e afërt me fjali të tilla si *Folë!*, *Vazhdo, pra!*, *Po të dëgjoj!* etj.

— Një gërritje e zgjatur i bëri që të ngrejë kokën e të shohin nga shtrati. — Oni! — tha karrocieri. — Po zgjohet! Po zgjohet! Por Oni nuk u zgjua. U kthye nga ana tjetër dhe vazhdoi të flinte. — *Shët!* — tha Xhuxhumaku. (Gj. Zheji, Pupagjeli, 112); Këtu *shët* shpreh urdhër dhe ka vlerën e fjalive të tilla si *Heshtni!*, *Mbylleni gojën!*, *Kërkush të mos flasë!* etj.

Banakieri — Ju plakat jeni akoma me të vjetrën. Po mblidh gjuhën e mos na e shaj atë vajzë, se e kemi si dritën e syrit... Plaka — U, u! (K. Blushi, Drama, 32). Këtu, U,u! shpreh habi dhe ka vlerën e fjalive të tilla si *Unë nuk e prisja këtë nga ju!*, *Po më çudit!*, *Të jetë e vërtetë kjo?! etj.*

Me që përbajtjen nuk e kanë të përcaktuar qartë, këto fjali thirrmore përdoren shpesh të shoqëruara me ndonjë fjali tjetër, që shpreh të njëjtin reagim, por më të përcaktuar e më të hollësishëm dhe që tregon qartë gjithshka që i takon ndjenjës a dëshirës së shprehur nga folësi. P.sh.

— *Oho!* Dolli thëllëza nga çerdhja. (S. Pitarka, Familja, 59); Smaili e cëmbidhi fort në kofshë të vëllanë. «*Shëëëët!* — ja bëri ngadalë, — mos kthe fjalë!» (N. Prifti, Çezma, 94); Vasilika: *U!* Kaqë koshient qënka shoku Bexhet? (S. Çomora, Nga fshati, 44).

Sigurisht, fjalitë thirrmore (të ndërtuara me pasthirrma) janë më konkrete e më të përcaktuara në bashkëvjatje me situatën dhe kontekstin. Këtë mund ta vëmë re edhe në shembujt që janë dhënë. Fjalitë thirrmore janë karakteristike për gjuhën e folur. Ato janë të pazbërthyeshme e të paanalizueshme në gjymtyrë të veçanta edhe kur përbëhen nga dy a më shumë fjalë, të cilat kanë humbur a dobësuar kuptimet leksikore dhe funksionet gramatikore përkatëse, kanë marrë veçoritë e pasthirrmave dhe kanë kuptim tërësor. Fjali thirrmore të pazbërthyeshme e të paanalizueshme në gjymtyrë të veçanta formohen shpesh edhe nga ato pasthirrma që e kanë prejardhjen nga bashkime të qëndrueshme frazeologjike ose nga ndonjë fjali e plotë a e cinguar. P.sh.

Zëri i Muhametit — Hyni, bre, hyni ju! Dhimitri — (hyn duke qeshur) *Djall o punë!* Ja mirë se ju gjejmë! Qysh jeni, mirë? (S. Pitarka, Heronjtë, 34); Unë u thosha shokëve: Ejani të vemi këtej nga Lopatat. Ata hiç... *Dreq o punë!* (Z. Sako, Medalja e trimërisë); Ai e shikoi Vangjelin drejt në sy, buzëqeshi e tha: *faleminderit*. Pse të ta bëj dëm? (Sh. Musaraj, Isha unë, 76); *Mirëmëngjezi!* E freskët, e re jeta u zgjua. (F. Arapi, Ritme, 66); *Tungjatjeta* — ja pat Llazi ftohtë. (Sh. Musaraj, Isha unë, 147).

Pra, pasthirrmat përdoren shpesh të mëvetësishme dhe formojnë fjali thirrmore. Por, ato përdoren shpesh me vlerën e një fjale të vetmuar sintaktikisht në përbërjen e fjalisë. Në këto raste pasthirrmat lidhen ngushtë me fjalinë përkatëse, shërbejnë vetëm për të shprehur a nënvizuar nuancën emocionale të fjalisë dhe veçohen nga fjalët e tjera të fjalës me presë. Kur përdoren në këtë funksion, ato duhen përfshirë në grupin e fjalëve gramatikisht të palidhura me fjalinë. Këtë shërbim e kryejnë pasthirrmat që shprehin ndjenja. Në raste të tilla ato mund të bashkohen nga pikëpamja e intonacionit me fjalën që vjen pas. P.sh.

Ah, ç'ja ke punuar një herë Sali Protopapës në atë mbledhjen para se të niste vëllavrasja. (D. Agolli, Komisari, 190); Ah, i vraftë Pej-kamberi! (D. Agolli, Komisari, 55); — Oh, sikur të kisha krahë të fluturonja, të iknja larg, larg, atje ku nuk i dëgjohet grahma Kuma Maros... (M. Kuteli, Xinxifilua, 48); Oh, sa më është bërë qejfi! Mal! (A. Kristo, Shkëndijat, 529).

Me vlerën e një fjale të vetmuar sintaktikisht në përbërjen e fjalisë, pasthirrmat i gjejmë në mjaft raste të vendosura brenda fjalisë. P.sh.

Po! Atij sa dolli hëna i mbet kënga, *ah*, në grykë, e për tokë u rrëzua, edhe më s'i hapi sytë... (A. Varfi, Në zgjim — Këngë e ritme, 32); Pse nënqesh me buzët, *ah*, të shkreta. Më nj'anë hiqesh, rri gjith' e larguar? (Asdren, Ëndra e lotë, 209); Në tufan, në shi, në borë. Edhe sikur të ishin hekur. Kaqë vjet, *oh*, kaqë vjet, Do i'n tretur maleve! (M. Xhaxhiu, Partizanët, 10).

Pasthirrmat që u takojnë thirrurëve, nga pikëpamja e intonacionit bashkohen me ta. P.sh.

— *Qyqja*, burrë! Ç'më bane? — thotë. T'thashë: Do na marsh m'qafë» — thotë (Folklor shqiptar, Proza popullore, IV, 177); Djali nuk pati kohë ta pyesë se kush i kish bërë gjithë këto. Ai i mori me mend e me vehte nisi të dëshpërohet, duke thënë: «*Ah*, Hamit, Hamit!» (Dh. Shuteriqi, Çlirimtarët, 85); — *Ah*, shejtankë, shejtankë! S'bën nëna, ë? (P. Marko, Hasta, 354).

Pasthirrmat nuk lidhen nga pikëpamja sintaktike me pjesët e tjera të fjalisë, prandaj edhe nuk janë gjymtyrë të saj. Megjithatë, herë-herë, ato mund të lozin rolin e një gjymtyrë të fjalisë, të kallëzuesit të shumtën e herës, por edhe të një rrethanori. P.sh.

a) *si kallëzues:*

T'i mbash me vete ke frikë se të kontrollojnë, t'i fshehësh më ndo një cep të shtëpisë ke frikë se mos i bie zjarri dhe *hajt* pastaj t'i gjeshe në mes të gërmadhave. (V. Kokona, Hijet, 52); Unë nuk e kuptoj xhanëm, ç'farë lezeti i ndjejnë atij bulevardi, *hajde* vërdallë si kali në lëmë. (M. Kallamata, Netë, 56); Ngarkohuni dhe marsh në brigadë! — urdhëroi Agimi: (F. Gjata, Brezat, 192);

b) *si rrethanor:*

Hajde — *hajde*, miqësia nisi të ftohet, vëllazëria të shuhet. (M. Kuteli Xinxifilua, 204); *Hop* nis gumëzhin tërë pylli. (M. Kuteli, Xinxifilua, 60); Ua mbledh unë edhe burrave edhe djemve. *Sus* rrinë. (R. Brahimi, Zgjim, 140).

Shpesh pasthirrmat substantivohen dhe shërbejnë si gjymtyrë e fjalisë. Të substantivuara ato përdoren sidomos në cilësinë e kryefjalës dhe të kundrinës. Në këto raste nuk shërbejnë më për të shprehur ndjenja dhe mund t'i gjejmë të përdorura me parafjalë, me ndonjë fjalë përcaktuese dhe me forma të ndryshme në numër e në rasë. P.sh.

a) *si kryefjalë:*

Një pëshpëritje e një «*a-a-ah*» i zgjatur fluturoi. (A. Abdihoxa, Para furtunës, Ëndra e dritë, 83-84); Sepse një nënë u pat rritur, me lot e vaj edhe rënkime, sepse një *ah* edhe një brengë, u mbushi zemrat hidhërime. (A. Varfi, Në tingujt e revolucionit, 68); Një «*urra*» e fuqishme u ngrit n'atë rrëmujë, oshëtim' e gjëmim të paprerë... (P. Marko, Hasta, 417);

b) *si kundrinë:*

Po e duronte pa bërë asnjë *oh*! (Th. Kacori, Për mëmëdhenë, 186);

Gjoksi i madh nuk nxori *ohe* e *ahe*. . . (D. Agolli, Mesditë, 68); Nxori një *of* me grykë, shau ndyrë dhe, duke shëmtuar fytyrën të verdhë e pak si të nxirë, futi në gojë gishtin e madh të dorës së majtë, të prerë pak afër thoit. (F. Gjata, Në pragun e jetës, 13); — Lëri *ahet* dhe *uhet*, po ulu aty se je mirë tha Azapi. (I. Kadare, Kështjella, 178); — Mos ua vërë veshin «*of*»-eve të tij, ti shoku mallakastriot. . . Ai ka dalë, sot, për gjah, që të qëllojë në kokë «*of*»-et e zemrës... (J. Xoxa, Juga, 463).

ONOMATOPETË

Onomatopetë përbëjnë në vetëvete një grup të veçantë formimesh, që, ndryshe nga pasthirrmat, nuk shprehin ndjenjat, dëshirën a vullnetin e folësit, por shërbejnë për të riprodhuar tingujt, zërat, zhurmën, britmat, klithmat etj. të sendeve e fenomeneve të ndryshme të realitetit objektiv:

a) të njerëzve, p.sh.

Sa ftohët bën! *Bërr!* — tha burri me kapele kashte. (Gj. Zheji, Pupa-gjeli, 118); Nga të ftohtit Gjyla kishte futur duart në futë, kurse Lavdia i fërkonte me njëra tjetrën e i ngrohte me frymë «*fu-u-u*». (A. Abdi-hoxha, Tri ngjyrat, II, 30); Dhe qeshte me gazin e asaj dhe të kësaj nate: «*Ka... ka... kaaa!*» (J. Xoxa, Juga, I, 130); *Khe, khe!* Po rrini? — u kollit Rrapua. (D. Agolli, Komisari, 239); Njerëzia panë shoqi-shoqin. Gratë, si ç'e kanë zakon, zunë e po bëjnë *pësh-pësh-pësh*. (Dh. Shuteriqi, Kënga dhe pushka, 30); — *Hapçiu! Hapçiu!* — tështiti plaku dhe nxori me të shpejtë nga jeleku një shami të madhe të kuqe, me ca pika të bardha anëve. (F. Gjata, Tana, 18);

b) të shpendëve, p.sh.

Harabeli «*ciu-ciu*» dhe «*fërr*» ja pat para syve të tij. (A. Abdi-hoxha, Ëndërra, 60); Në oborr, në degët e dendura të një portokalli, ia thoshte përvaishëm një kumuri: *gu-gu-gu*. (A. Abdi-hoxha, Tri ngjyrat, 61); Sa fillon drita me zbardhë, gjel-kokoshi hop mbi gardh. Ze thërret «*ki-ki-ri-ki!*», se mëngjezi paska gdhi. (A. Gjyli, Djathtas, 2); *Kllu-kllu-kllu* ja bën klooçka. (Z. Sako, Fëmijët, 19); Thëllënza çukiste gëzhuta dhe këndonte me një zë të ëmbël e gazmor. *Kuqili-kuqili, kuqili-kuqili!* (A. Kristo, Shkëndijat, 533); Rrosa bënte *vak, vak, vak*, Pula bënte koqeve... (Th. Mitko, Bëleta shqypëtare, I, Instituti i Folklorit, Mbledhës, II, 44); Bleta doli tek hyrja e zgavrës. — *Zë-zë-zë!* — ja bëri ajo. — Ç'kërkon o buf? (Yllkat, 5, 1972);

c) të kafshëve, p.sh.

Venë në mbreti bënë donoma të madhe, vete gjarpri *fësh! fësh!* në krye të odës. (Folklor, III, 130); Krismat *bam! bam!* Zagarët *ham-ham*. Lere mos e pyet. (M. Kallamata, Netë, 51); Kali im s'bën *hi! hi! hi!* Un' i hedh bar e tagji, Po s'i ha e ujë s'pi! (Z. Sako, Fëmijët, 16); *Vuu-vuu* ban furtuna, *Uuu-uuu* mblidhen ujqit. (Q. Guranjaku, Xixëllonjat, 87); Kemi një sprihe me njëqind kokë këtu. Kemi një maçok me lesh. Duket

si i ngordhur, po rri, rri e ja bën: zhzhzh; Zhzhzh! e na copëton me thonj. (F. Gjata, Brezat, 165); — *Tuk-tuk-tuk!* — çukiti qukapiku në një dru. — Është e vërtetë. Edhe unë e pashë me sytë e mi. (Yllkat, 5, 1972);

c) të sendeve dhe të fenomeneve të natyrës, p.sh.

Gjylet fluturonin mbi qytet dhe pëlcisnin matanë me një zhurmë të llahtarshme; — *Bëzz-bum! Bëzz-bum.* (A. Kristo, Shkëndijat, 481); Kërcasin sëpatat druvare: *trah-tarah!* Në pyjet e Pukës. (D. Agolli, Mesditë, 26); Me gëzim e nisi, Por shumë shpejtë e hodhi, Ah, edhe kjo fshesë, *Fësh-fësh-fësh* — më lodhi. (Fatosi, 7, 1972); Lart punonin të gjitha: *trakër-trukër, trakër-trukër* bënin okllaitë. (V. Kokona, Me valët, 183); *«Trn-trn! Trnn!* «telefoni. (P. Marko, Hasta, 405); *Bu, bu, bu,* ja ku pas ca kohë, na duket që po vjen një re sterrë e zezë, e cila qëndron përmbi krerët e të treve. (Folklor, I, 385); E jashtë, *frap... e frap,* bënin vetëtimat e kërcitnin bubullimat që të shurllonin e shiu binte i pa prerë e më të madh. (V. Kokona, Plaka dhe plaku, 89); Era hidhte valle, vërtitej dhe ulërinte: — *Vuu! Vuuu!...* (Gj. Zheji, Pupagjeli, 15); Dimri s'kish të sosur. Shiu vu nat e ditë jashtë dhe brënda në shtëpi. (A. Çaçi, Na hoqnë çatinë, 11).

Riprodhimi që u bëhet tingujve, zërave, zhurmës, britmave, klithmave etj. të sendeve e fenomeneve të ndryshme të realitetit objektiv me anën e onomatopeve është gjithmonë i përafërt dhe asnjëherë i plotë e i përpiktë.

Shpesh për të riprodhuar të njëjtin tingull, zë, zhurmë, britmë e klithmë etj. të një sendi a fenomeni të dhënë të realitetit objektiv, përdoren formime onomatopeike me përbërje të ndryshme tingullore. Kjo ndodh, ndërmjet të tjerave, sepse tingulli, zëri, zhurma, britma a klithma e sendit të dhënë të realitetit objektiv, që përftohet në të njëjtat rrethana, mund të perceptohet e të riprodhohet në mënyra të ndryshme nga njerëz të ndryshëm. Kështu, p.sh., për të riprodhuar zhurmën që shkaktohet kur bie një send në ujë nga një farë lartësie, rëndë e në një vend me thellësi, përdoren formimet onomatopeike *bëllduf, gëlldup, gëlldumb* etj., për të riprodhuar të kolliturit e një njeriu që po e «mbyt» kolla, sepse është mjaft i ftohur, ose pi shumë duhan, përdoren formimet onomatopeike *khu-khu, kuh-kuh, kum-kum, ku-ku-ku* etj. Krahaso:

a) për të rënë e një sendi në ujë:

I shinja, more djema, për besë, i shihnja se si rrëzoheshin nga gremina e Zaverit *bëllduf* brenda mu në liqen. (S. Spasse, Ata nuk ishin, 249);ndërsa i kishte sytë lart të ngritur, nuk pa se ish një pus aty përpara dhe ra *gëlldup*... : (S: Çomora, Sorra dhe pëllumba, 35); S'di se si i rrëshqiti këmbë e *gëlldumb!* brenda në det. (M. Kuteli. Xinxifilua, 123);

b) për të kolliturit:

Plaku i Hyskës kollitej në një qoshe: *khu-khu... khu-khu...* (N. Prifti, Tregime, 62); — *Kuh! Kuh!* — u kollit përsëri plaku mu te dera dhe menjëherë u dëgjua zëri i tij pak i ngjirur. (F. Gjata, Tana, 45); ... *kum, kum, kum,* e mbyti ballgami. (A. Abdihojha, Një vjeshtë, 150);

Plaku filloi të tronditej. Një gulçim i preu fjalën dhe e shkuli kolla. *Ku-ku-ku! Ku-ku-ku!* (A. Kristo, Shkëndijat, 531);

Por shpesh përbërja tingullore e ndryshme e onomatopeve pasqyron tingujt, zërat, zhurmën, britmat, klithmat që përftohën ndryshe te i njëjti send i dhënë i realitetit objektiv, ose te sendet e një fare, sidomos në rrethana të ndryshme. P.sh. sipas llojit të të qeshurit në gjuhën shqipe përdoren mjaft formime onomatopeike: *ha-ha-ha*, *he-he-he*, *hi-hi-hi*, *ho-ho-ho*, *ku-ku-ku* etj. Krahaso:

Nënë, moj, nënë, *ha-ha-ha!* — qeshi e thirri ai me zë gazmor. (A. Abdi-hoxha, Një vjeshtë, 201); — *He-he-he!* ... — qeshi me zorr agai. — (P. Jusufi, Përrenjtë, 46); Dhe qeshte duke treguar nofullat e tij pa dhëmbë: — *Hi-hi-hi!* (A. Kristo, Shkëndijat, 529); — *Ho, ho, ho!* — qeshi Guri. (D. Agolli, Komisari, 64); Çupëzat qeshën *ku-ku-ku* dhe u turpëruan e u skuqën si ato mollët në degë, kur vjen vakti e duhen këputur. (Dh. Shuteriqi, Kënga, 30).

Kështu ndodh edhe për sendet që përmendëm më sipër: njeriu që bie në ujë ose që kollitet. P.sh. kur sendi bie në ujë vend të cekët dhe «urtë e butë» (pa «-dumb»), përdoren formime onomatopeike me përbërje tjetër tingullore (*plluq*, *pëlltuq*, *bëllduq*, etj.), kur dikush kollitet lehtë e nuk e «mbyt» kolla, përdorim zakonisht «*hëm*». «*hm-hm*». Krahaso:

Vita si ia pati shkrepur gazit në kohën që beu ra «*plluq*» në ujë, mbylli veshët dhe uluriti kur gjahtari qëlloi mbi bujkun. (J. Xoxa, Lumi, II, 85); — *Hëm, hëm*, — u kollit plaku dhe u ul pranë saj. (I. Dedi, Këngëtarja, 10); *Hm! hm!* — u kollit plaku. (P. Marko Hasta, 13).

Disa onomatope kanë përbërje fonetike mjaft të përcaktuar në gjuhën shqipe. p.sh.

be (qengji, delja, dashi):

Be, be, be! — e thirri aty afër delja. Çobani u hodh pas shkëmbit dhe pa se delja kishte mbetur në një çark nga ato që zënë kunadhe. (A. Cerga, Bukuria e jetës, 61); Qengji i vogël, *be, be, be*, mir' se erdhe sot tek ne. (Ll. Nano, Vala, 14);

ciu (zogu):

Ciu-ciu, bëjnë zogjtë nëpër degë, që Xinxifilua me të vëllanë të ikin larg e më larg. (M. Kuteli, Xinxifilua, 90); Kur del dielli, kur bjen shiu, tha trumcaku, — bëj *ciu-ciu!* (L. Staku, Yllkat, 1, 1972); Kllu-kllu-kllu ja bën kllçoça, *Ciu, ciu, ciu*, ja bën zoçka. (Z. Sako, Fëmijët);

fësht (rrëshqitja):

Andon Buzo: E merr bota, plakëëë... Të shket malli nga dora mu si zhivë, *fësht!* (S. Çomora, Nga fshati, 55); Ngriti dorën për ta goditur, po Rizaj, «*fësht*» ja pat nën ujë. (A. Abdihoxha, Tri ngjyrat, I, 76);

fiu (fërshëllima):

— Na, Rusaaaa! *Fiuuu!* Ai fërshëlleu fort. (K. Kosta, Bisedë, 91); — *Fiuuuuuu!* — u dëgjua një fërshëllimë. (J. Xoxa, Jugu, 353).

ga-ga-ga (pata):

— O moj patë e bukur patë, ec këtu ndihmomë pak, dua të notoq si ti, ti u zhyte bukuri! — *Ga-ga-ga*, o dhëpër plakë, nuk më shtie dot në lak. (F. Çakërr, Zemra, 17); Po kur erdhë në shtëpi, pata çirrej *ga-ga-ga!* Kërkon bibat në avlli, Kërko biba, biba s'ka. (Z. Sako, Trëndafilat, 30);

gu-gu-gu, (pullumbi):

— Më dëgjoni, jam këtu, — tha pëllumbi, *gu-gu-gu*; (L. Staku, Yllkat, I, 1972); «*Gu-gu-gu*» vida e pëllumbit, se atyre u del gjumi. «*Fërr-fërr-fërr*» kanë kujdes gjimnastikën çdo mëngjes. (A. Gjyli, Djathtas, 6);

krra (korbi):

Disa korba të tulatura nëpër hijet e gjerdheve, u ngritën lart, të trembura, e sikur shanë e mallkuan beun me gjithë maqinë: — *krra-krra! krra-krra!* (Dh. Shuteriqi, Çlirimtarët, 46); — *Krra! Krra!* Ky di më shumë nga ç'thotë me krahët e tij. Për rrugë, veç kësaj s'e ka shokun. (Gj. Zheji, Pupagjeli, 58);

Ku-ku (qyqja):

— Në këtë kohë qyqja, duke fluturuar degë më degë, hapi bishtin. zgjati krahët dhe ja nisi këngës: *Ku-ku!* (Këndimi, kl. III, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, 1971, 219); Vetëm qyqja e kuqe kukat në një rrem të thatë dhe kënga e saj kumbon kobshëm valtheve e lugjeve: *Kuku, kuku!* (M. Kuteli, Tregime të moçme, 188);

me (dhija, keci):

Meee! — përplasi me padurim thundrën mbi tryezë Keci që dinte të numëronte deri në dhjetë. (Fatosi, 2, 1973); Lopa, delja edhe dhia, nisën prapë që të tria: Mu-mu-mu e *me* — *me-me*, mu — mu-mu e be — be — be, pse nga tri të kemi ne?! (Yllkat, 4, 1971);

Kuak (bretkoca):

— *Kuak! Kuak!* — ja bëri si bretkocë e vërtetë. (A. Abdihoqha, Tri ngjyrat, 45); Kur ja, para tyre doli një bretkosë. — *Kuak-kuak, kuak-kuak!* përshëndeti ajo. (B. Gaçe, Shtëpia, 22);

mjau (macja),

... kafsha e bardhë e pastër, si top i madh dëbore, ja bën «*mjau*» e bezdisur dhe ikën me vrap (Gj. Zheji, Pupagjeli, 5); ... dhe vështronte nga unë, sikur të më lutej me sytë dhe me mjaullimat: — *Mjau! Mjau!* Nem edhe mua një dallëndyshe, të los me të! (Dh. Shuteriqi, Gurnecka, 11);

mu (viçi, lopa, kau):

— Duket viçi e ka barkun bicë, ndryshe do të sillej vërdallë e do të bënte: «*Mu, mu!*» tha Beni si specialist. (P. Zoto, Verka, 145); Lopa pallte: *mu* — *mu-mu*, viçin tim sa fort e du! (Q. Guranjaku, Xixëllonjat,

50); — *Muuu, muuu!* ja bëri kau me yllin e bardhë mbi ballë; përpoqi këmbët dhe u ngrit. (S. Spasse, Buzë liqenit, 78);

tak-tak (trokitja);

Ç'të bëjnë, ç'të bëjnë — që të mos flenë jashtë — djali trokiti në një derë. — *Tak — tak, tak — tak.* (M. Kuteli, Fshati im, 29); — *Tak-tak! Tak — tak!* — troket papandehur dera dhe hyn brenda fshatari, të cilin Petriti e kishte dërguar në qytet. (S. Spasse, Kurora, 105);

tik-tak (sahati);

Tik-tak, tik-tak, punon ora mbi oxhak. *Tik — tak, tik-tak,* ecën gripi pak nga pak. (S. Çomora, Shkolla, 5); *Tik — tak, tik — tak,* bije ora pa pushim. — Merrni pionerë librat me nxitim. (Q. Guranjaku, Xi-xëllonjat, 43);

ty — ty (boria e automobil);

Pa nis maqina me shpejtësi të ecë rrugës, porsi veri. — *Ty-ty, ty-ty, ty-ty, ty-ty!* Bije bori, këtu, aty. (B. Gaçe, Teuta, 14); Shiu në të tijën, maqina po me gazin në dërrasë, boria *ty-ty-ty, ty-ty-ty* — tamam për dasmë. (R. Pulaha, Një vajzë, 41);

ta-ta-ta (boria e borizanit);

— *Ta — ta — ta! Ta — ta — ta!* Gjëmoi boria brenda në shpëllë. (P. Marko, Shpella, 51); Atë kohë u hap dera e dhomës dhe u dëgjuan zërat e burisë dhe të trompetës: «*Ta — ta — taaa!* Pum — pum, pum — pu — ru — pum!» (B. Dedja, Kallëzimet, 14);

Vu (era);

— Fryn era, *vu, vu, vu!* Bie dëborë edhe shi, ndezin stufat në shtëpi. (A. Gjyli, Djathtas, 15); «*Vu — vu — uu*» frynte era e tërbuar e janarit. (B. Dedja, Kapiteni, 36); Era e ftohtë dilte nga luginat dhe andej endej nëpër fushë *vuuu, vu, vu.* (Fatosi, 4, 1972).

Në letërsinë artistike si formimet onomatopeike ashtu dhe pasthirrat që na paraqiten si formime nga përsëritja e së njëjtës gjymtyrë, i gjejmë të përdorura me vizë lidhëse, me presje, me pikëçuditëse, ose me pika ndërmjet gjymtyrëve, por në shumë raste edhe pa to, me gjymtyrë të ndara nga njëra tjetra ose të përngjitura me njëra tjetrën. Në disa nga këto formime, në varësi nga konteksti e rrethanat e vërteta të ligjëritimit, gjymtyrët mund të përsëriten më shumë së dy herë. P.sh.

Mihallaqi — (i mallëngjyer). Më kujtohet ajo ditë që u ndamë, *pa-pa-pa*, sa prekëse ka qenë. (Dh. Dhima, Kur hapet perdja, 23,1970); — *Pa... pa... pa* ç'njerëz! — u ankua Danja. — E kanë lënë këtë qoshe pa korrur, se ka gjembaçë (T. Laço, Toka, 280); — *Pa, pa* ç'dimër! — i tmerrshëm! Në Korçë bie vërtet dëborë, po sikur s'bënë kaq ftohtë. (N. Turhani, Rojet e fortesës, 1969, 6); — *Papapa*, — tundte kokën xha Nashua. (Sh. Musaraj, Isha Unë, 153);

— *Ha-ha-ha-ha!* Sa bukur e ke lojtur! — i tha. — (A. Kristo, Shkëndijat, 529); — *Ha... ha... ha...*, qeshi Leksi me të madhe. — Të shkoj fyshnjera bosh këtë radhë, o byrazer!... (J. Xoxa, Lumi, I, 206); — *He*,

he, he! qeshi Qamili. (S. Godo, Zëra, 111); — *Ha!ha!* Ç'më qeshet kur shikoj se po dredhon si prostitutë, Tani tregohesh si kunadhe, Pastaj si një pëllumb, i butë. (M. Xhaxhiu, Rapsodi, 12); — E di unë se ç'revolucion i pëlqen kësaj... *ha ha ha!* — qeshi ai. (D. Agolli, Komisari, 70); Pale, po i paska shkrepur të marrë të bir'e mbret burrë... *Hahaha!* Po të të teket për mish, there, haje. (M. Kuteli, Xinxifilua, 177);

Në disa formime onomatopeike gjymtyrët mund të paraqiten me ndryshime të pjesshme të zanoreve e të bashkëtingëlloreve (*ham-hum, paf-puf, gëk-mëk* etj.). P.sh. — Hesht, bijë, se e sbras djali vetë, thirri Zonj'e madhe dhe ja dha *gau* — *giu!* bataresë nga oxhaku, sa u hoth tërë fshati përpjetë. (M. Kuteli, Netë, 29); Apo nuk shtiu atyre maleve me pushkë, «*paf-puf*», s'rrëfhehet me gojë, qimen në vetull të merr. (A. Abdi-hoxha, Një vjeshtë, 92). Kjo ndodh, sepse gjymtyrët përdoren të mëvetësishme edhe me përbërje të ndryshme fonetike, gjë që pasqyrohet në formimet e mësipërme.

Në të gjitha formimet e mësipërme mendojmë se duhet përdorur viza lidhëse ndërmjet gjymtyrëve, sepse në gjuhën shqipe, si rregull, të gjitha formimet e përfutuara nga përsëritja e se njëjtës fjalë shkruhen me vizë lidhëse (krahajo: *copë-copë, çika-çika, grupe-grupë, herë-herë, shumë-shumë* etj.). Përveç kësaj pikat e heshtjes dhe presa kryejnë të tjera shërbime në gjuhën shqipe.

Disa formime onomatopeike, sidomos ato që shoqërojnë veprime dhe akte fiziologjike të njeriut (të qeshur, të kollitur, të ngjethur, të fërshëlyer, të gërhitur, të pështyrë etj.) përdoren shpesh edhe për të shprehur ndjenja të ndryshme: frikë, përbuzje, ironi etj. Kjo është karakteristike sidomos për gjuhën e folur. P.sh. — *Kuku*, u trenue.... U trenue! — bërtiti vajza, tue u tërheqë kah dera. . . (S. Sulejmani, Njerëzit, 263); *Ku-ku*, moj nënë, po ne me këto grindje, me këto kafene e me këtë raki jemi rritur! (A. Abdi-hoxha, Tri ngjyrat, 96); Puntorët bënin grevë... dhe tek ne kjo do të ndodhë... *hm!* demokracia! Mirë xhanëm... po sikur... tepër pe ka marrë sot në dorë harbutëria!... (M. Xhaxhiu, Rapsodi, 9). Në këto raste *ku-ku, hm* s'janë më onomatope, sepse nuk shërbejnë për të riprodhuar tingujt, zërat, zhurmën, britmat, klithmat, etj. të sendeve përkatëse të realitetit objektiv, por janë pasthirrma, me të cilat shprehim ndjenja nga më të ndryshmet.

Onomatopetë përdoren zakonisht të vetmuara dhe nuk u nënshtrohen lidhjeve të zakonshme sintaktike me pjesët e tjera të fjalisë, prandaj nuk janë gjymtyrë të saj. Krahajo: *Dang-dang! Dang-dang-dang! Dang-dang-ding!* — Kjo e rënë e përmortshme e kambanës e kishte bërë baca Nduen kufomë. (S. Spasse, Zjarre, 184); *Tan — tan — tan — tan!* Katër orë mbas dreke! Sa mizorisht therin midën e punëtorit. (Migjeni, Veprat, 127); — *Gërr — gërr — gërr*, —s'i hoqi buzët Qazimi deri sa e thau fare faqoren. (A. Abdi-hoxha, Një vjeshtë, 153); *Ha-ha-ha, hi-hi-hi!* Mirë ta bëri o Nurëdin. (N. Prifti, Çezma, 22); *Mjau! Mjau!* Nem edhe mua një dallëndyshe të los me të. (Dh. Shuteriqi, Gurnecka, 11).

Por, sikurse pasthirrmat, onomatopetë mund të lozin herë-herë rolin e një gjymtyrë të fjalisë, veçanërisht të kallëzuesit dhe të rrethanorit. P.sh.

a) si kallëzues:

Më lanë meskëputur, po të them... Sa merrja veten nga dasma, *bam* vdekja në derë. (R. Brahimi, Kthesa, 96); Moj mos ke ndërmend të bëhesh politikane ti? *dër, dër* gjithë ditën me atë gazetë dhe as vetë nuk di ç'këndon. (R. Brahimi, Tregime, 93); Po s'më dëgjoi njeri, Njëri *fësht* këtej, tjetri *fësht* andej... (A. Çaçi, Na hoqnë, 21); At natë qi erdh kjo, u çu në misnatë, e veshi fustanin e kuq, mori shandanin në dorë dhe shkoi te mreti. *Tak, tak*, në derë. (Folklor, Proza popullore, 537).

b) si rrethanor (kohe e mënyre):

Mihali s'e humbi, po u ngre *brraf* më këmbë të vështrojë, (J. Xoxa, Novela, 82); Pse nuk e thosh *brram* atë që kish për të thënë? (Dh. Shuteriqi, Çlirimtarët, II, 186); Një ditë prej ditësh Jusufi i havaneve, na u ngriti me bastun në dorë, rrumaduc e i trashë siç ishte dhe *çap-çup* shkoi te shoku i vet. (A. Abdihojha, Ëndërra, 41); Punonte sa punonte, ose bisedonte sa bisedonte, dhe *fap*, menjëherë, si pa dashje, sytë i vinin te ajo gozhdë. (M. Zaloshnja, Nën hijen, 130); Pa, ata djemtë e mi dhe ky axhamiu yt, si eshka e thatë, të thatë nga trutë, marrin zjarr *fët*... (J. Xoxa, Lumi, II, 45); Në kohë dreke *pup* na vjen dhe i dhëndri. (Lipi, Fatbardhi, 50).

Përgjithësisht njësitë onomatopeike, sikurse pasthirrmat, shërbejnë si gjymtyrë të fjalisë, kur substantivohen. Në këto raste edhe njësitë onomatopeike mund t'i gjejmë të përdorura me parafjalë, me ndonjë fjalë përcaktuese dhe në forma të ndryshme në numër e në rasë. P.sh. Dhe qeshte e qeshte me *hiihi* të zgjatura, që Afizit i gërvishnin veshin. (Sh. Musaraj, Para, II, 430); Gurgullima e lehtë e përroit, që gjarpëronte buzë ullishtës, mbytej nga *kuak-kuaku* i pandërprerë i bretkosave të panumurta. (A. Abdihojha, Një vjeshtë, 4); Ç'janë ato «*pësh — pëshe*» në fshat?... (J. Xoxa, Juga, 25); Dukej sikur nën *tam tame* e shtërgatë lëvizte Sahara, (I. Kadare, Përse mendohen, Poema, 107).

Kur substantivohen, njësitë onomatopeike përdoren shpesh sidomos si kryefjalë dhe si kundrinë. P.sh.

a) si kryefjalë:

Në pyllin e dendur të kashtës dëgjoheshin *fëshfëshe* të gjata, (R. Nepravishta, Pelikanët, 60); Pakë më larg dëgjoheshin *grap-grupet* e çizmeve të ushtarve armiq dhe britmat e grave e të fëmijëve, të cilët ndoshta qanin se u merrnin prindërit dhe vëllezërit e tyre në burg. (Q. Guranjaku, Tetë ditë, 52); *Kikiriku* i një këndezi ndolli të këndonin edhe ata pak këndeza të tjerë, që kishte fshati. (S. Spasse, Afërdita përsëri, 191); *Tiktaket* monotonë të sahatit të murit, ia shtonin harmoninë. (B. Sinaeri, Kokrra aguridhe, 14);

b) si kundrinë:

.... mori velenxën e u mbulua kokë e këmbë, që të mos dëgjon-te më *pëshpëshet* e të kushurinjve. (J.Xoxa, Lumi, I, 218); Pasi i bëri me shnjë bujkut të konakëve të mbylltë portën, priti sa u përplasën kanatet dhe pastaj lëshoi frerët e pelës dhe një «*ëh*» çlirimi. (J. Xoxa, Lumi, III, 190); Moj po dëgjo se ç'thotë, se janë gjëra shumë delikate, dhe leri *përrpërrpërret!* (S. Çomora, Syleshi, 114); Prekte zemrën me dorë dhe dëgjonte *vapvupet*. (V. Sejko, Orë të vështira, 112).

Ndryshe nga pasthirrmat, onomatopetë karakterizohen, ndërmjet të tjerash, nga mundësitë fjalëformuese⁴⁸. Mbi bazën e tyre janë formuar një sërë fjalësh e shprehjesh në gjuhën shqipe. Natyrisht mundësitë fjalëformuese të onomatopetë mund të bëheshin objekt i një studimi të hollësishëm, megjithatë mendojmë se edhe kështu mund të nxirren disa përfundime:

1) Fjalët dhe shprehjet me prejardhje onomatopeike janë shumë të pakta dhe nuk përbëjnë ndonjë burim të rëndësishëm për pasurimin e fjalorit të gjuhës.

2) Në gjuhën shqipe, mbi bazën e njësive onomatopeike, janë formuar fjalë të kategorive të ndryshme leksiko-gramatikore sidomos emra e folje.

3) Në gjuhën shqipe nuk kemi fjalë të formuara me parashtesa, ose me parashtesa e prapashtesa njëherazi, mbi bazën e formimeve onomatopeike. Shumica e fjalëve të kësaj natyre janë formuar me prapashtesa. Fjalët e kategorive të ndryshme leksiko-gramatikore, të formuara mbi bazën e onomatopeve i kemi gjetur të formuara me këto prapashtesa:

a) *emrat*:

— *çe, gugu-çe*;

— *e, fëshfësh-e, taketuk-e, rraketak-e*;

— *ë, çang-ë, gllënk-ë*;

— *kë, çur-kë*;

c) *foljet*;

— *as, trok-as, kuk-as, zuk-as*⁴⁹;

— *i —, cicër-i-n*;

— *is, gu-is, ruf-is*;

48) Megjithatë gjejmë ndonjë fjalë a shprehje, sidomos në gjuhën e folur, të formuara me pasthirrma urdhërore (*hop-i, hëpërhë, hë e hë etj.*). P.sh.

— *Hëpërhë* t'i mbarojmë ato kanalet që kemi nisur. Më pas shohim e bëjmë. (P. zoto, Verka, 13); Nga Drithasi flakët ngriheshin në qiell. *Hë e hë* ecnin. (S. Spasse, Afërdita përsëri, 7); Na vihet si detyrë të bëjmë një hop cilësor përpara në shkollën tonë. (E. Hoxha, Raporte e fjalime, 1967-1968, f. 346, botim i vitit 1969, Tiranë).

